

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Eri MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7349 E premte 10 Nëntor 2017 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

## Opinion i Ditës

Nuk është më surprizë që në Shqipëri shumë tenderë, që në nisje janë abuzivë, apo edhe kur janë shpallur fituesit për ndërtimin e rrugëve apo kryerjen e ...  
Vijon në faqen 20

## Nga ERJOLA JATA

Vetingu i tenderëve



## Mesazhi i Ditës

Inderuar guvernator Sejko, i nderuar zoti Anastasakis, i nderuar zoti ministër, të nderuar të pranishëm, kriza botërore financiare na rikujtoi ...  
Vijon në faqen 21

## Nga ILIR META

Progresi i reformave, jetik për konvergim ekonomik me BE-në



Komisioneri i BE: Rezultate në 2018  
**Rama: Meritojmë të hapen negociatat. Hahn: Do presim rezultatet e vetingut**

Paralajmërimi i Bashës: Së shpejti, Shqipëria pa stabilitet. PD-LSI votojnë ligjet në Kuvend

Nga DARINA TANUSHI

Komisioneri për Zgjerimin në BE, Johannes Hahn bëri të qartë dje në Tiranë se Brukseli pret nga Shqipëria rezultatet e para të procesit të vetingut në fillim të vitit që vjen. Gjatë...

Në faqen 3,5

## LISTA ME EMRAT, 1500 ISH-TE PERNDJEKURIT QE DO TE MARRIN KESTIN E FUNDIT TE DEMSHPERBLIMIT

# ISH-TE DENUARIT, SI NDAHEN 352 MLN LEKE

Përfitueset e para janë janë ish-të dënuarat politike, të cilat janë gjallë në momentin e dhënies së pagesës. Prioritet kanë edhe ata mbi 75 vjeç



(Në foto) Ish-të përndjekur në protestë

Në faqen 14-17

## RAPORTI I KLSH-së: MINISTRIA SHKELI LIGJIN



Intervista/ Pedagogu i UT-së: Skema e regjistrimit penalizoi maturantët

Në faqen 13

Zbardhet skema/ Shefi i policisë, Cevallos: Viktima, objekt i një hetimi të mëparshëm

## Trafiku i kokainës, atentat shqiptarit në Ekuador

“Femra që e shoqëronte uli xhamin e makinës, atentatori qëlloi me armë disa herë”

Një shtetas shqiptar mbeti i plagosur në Ekuador të Amerikës Latine. Dysshohet se ngjarja ka lidhje me trafikun e kokainës. Mediat vendëse nuk japin emra, por mësohet se shqiptari ishte i shoqëruar me një femër gjatë atentatit. Ata po udhëtonin me një makinë të blinduar



në rrugët e Guayaquil-it, por gruaja që ishte me të uli xhamin për të pirë një cigare. Ngjarja ka ndodhur pasditen e 7 nëntorit 2017, në rrugët Tungurahua dhe Primero de Mayo, në qendër të qytetit Guayaquil. Atentati u njoftua të mërkurën nga...

Në faqen 11

## SHPERBLIMI

Qeveria, fond 1.8 mld lekë për pensionistët në fund të vitit

Në faqen 6

## HETIMET

Prokuroria: Tahiri përdori makinën e biznesmenit që u kap në Elbasan

Në faqen 8

## VENDIMI

Gjyqtarja e Genc Tafilit liron Ilir Pajën, u arratis nga burgjet italiane

Në faqen 9

## INTERVISTA

Gudar Beqiraj rrefën prapaskenat: Ja e vërteta e dorëheqjes sime

Në faqen 18

## INTEGRIMI DEKLARATAT

Kryeministri, kritika gazetarëve në ditën ndërkombëtare, në prani të komisionerit të BE

# Edi Rama: Media shkel të drejtat e njeriut, e pabesueshme për publikun

Komisioneri Hahn: Liria e medias, e rëndësishme për BE

Darina Tanushi

Kryeministri Edi Rama u shpreh dje në ditën ndërkombëtare të medias se ajo nuk duhet të vrasë në emër të lirisë. Duke vijuar sërish me kritikën e tij për mediat shqiptare, edhe në prani të kryekomisionerit Johannes Hahn, në Konferencën e Komisionit Evropian në Ditën e Mediave, Rama u shpreh: "Mediat në rajonin tonë, përfshirë dhe Shqipërinë, janë pjesërisht të lira. Përsa na takon, progres-raporti i vitit 2016 i Shqipërisë tri detyra shtëpia, për përmirësimin e gjendjes së mediave në vend, harmonizimin e legjislacionit për rritjen e transparencës, kufizimin e të drejtës së pronësisë së mediave në bazë të standardeve ndërkombëtare dhe forcimin e parësorisë së RTSH-së", u shpreh ai. Sipas Ramës, "roli i Televizionit Publik dhe AMA-s ka qenë shpesh në qendër të kritikave, për mungesën e profesionalizmit dhe politizimin të tyre e për këtë arsye ka nisur një proces i rëndësishëm reformimi në këto dy institucione". "Liria e shprehjes është një e drejtë themelore dhe është 'arma' më e fortë që kemi në dorë për të luftuar padrejtësinë, përfshirë edhe korrupsionin dhe shfaqjet e tjera negative në procesin e shtetbërjes, në funksion të integritimit të plotë në BE, por si një armë për të mbrojtur lirinë, vlerat dhe parimet e demokracisë dhe familjes europiane, ku ne, e përsëris, duam të bëhemi pjesë me të drejta të plota. Ajo nuk mund të përdoret për të vrarë pikërisht lirinë, vlerat dhe parimet mbi të cilat është ndërtuar i gjithë mekanizmi i funksionimit të saj", u shpreh kryeministri. Duke cituar Idro Montanellin, themeluesin e gazetarisë italiane, Rama: "Kurrë nuk i besohet një gazetarit të pasur". Dhe është e pamohueshme që sot, unë po flas për Shqipërinë, të tjerë mund të flasim për të gjithë rajonin,



Kryeministri Edi Rama

### BASHKËQEVERISJA

Kryeministri Edi Rama së bashku me koordinatoren kombëtare për bashkëqeverisjen, Elisa Spiropali do të zhvillojnë takimin e parë me njerëzit, të shtunën në qytetin e Burrelit. Sot qeveria pritet të mbledhet në Dibër, në vijim të traditës së krijuar tashmë prej marrjes së mandatit të dytë.

Ministria në Ministerialin e NATO-s: Do shkoj në Afganistan

## Olta Xhaçka: Vlerësimi për efektivet tanë, arsye krenarie

Ministriali i NATO-s, në nivelin e ministrave të Mbrojtjes, që u mbajt në datat 8 dhe 9 nëntor në Bruksel, konfirmoi vlerësimin që aleatët e Shqipërisë në NATO kanë për Forcat e Armatosura të vendit tonë. Gjatë dy ditëve të takimit, ministria e Mbrojtjes, Xhaçka mbajti fjalën në emër të qeverisë shqiptare, ndërsa zhvilloi takime të nivelit të lartë si: Këshilli i Atlantikut të Veriut apo takimi i ministrave të Mbrojtjes në kuadrin e luftës kundër ISIS, nën udhëheqjen e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Xhaçka rikonfirmoi angazhimin e



qeverisë për të përbushur të gjitha detyrimet që Shqipëria ka përkundrejt Aleancës si dhe detyrimin për të bërë të mundur, që buxheti dedikuar mbrojtjes të arrijë në masën 2% të PBB deri në vitin 2024. "Sa u takon misioneve tona paqeruajtëse,

shumë shpejt unë do të vizitoj kontingentin tonë në Afganistan, për të ndarë me ta ndjesinë e fortë të krenarisë që secili prej nesh ka, për punën e jashtëzakonshme që po bëjnë, por edhe për të shprehur mbështetjen e qeverisë shqiptare për çdo efektiv, por edhe për familjet e tyre", tha Xhaçka gjatë takimeve. Pak javë më parë ministria Xhaçka, gjatë një takimi në Komandën e Forcës Tokësore dha lajmin se Shqipëria i është përgjigjur kërkesës së strategjisë së re të presidentit amerikan, Donald Trump për Afganistanin, duke shtuar me një togë numrin e ushtarakëve shqiptarë në misionin "Resolute Support".

regjimit komunist. Një sens i humbur që i ka kthyer mediën atë sot në Shqipëri, në institucione të pabesueshme për publikun", u shpreh Rama. Nga ana e tij, komisioneri për Zgjerim, Johannes Hahn, e ka cilësuar lirinë e medias, një element mjaft të rëndësishëm për vendet aspirante



Kryeministri Edi Rama dhe Komisioneri për Zgjerimin në BE, Johannes Hahn

### GAZETARI MALAZEZ

Pas deklaratave të kryeministrit Edi Rama, gazetari malazez, Zeljko Ivanović i të përditshmes "Vijesti", i cili ishte i ftuar në panel, ka reaguar me indignatë duke thënë: "U ndjeva totalisht, si ta them... i sulmuar". Duke përmendur rastin e Maltës, ku një gazetarë u vra, ai tha se "këto lloj fjalimesh prodhojnë këto vrasje. Kryeministri atje për vite i thoshte gazetarës që nuk kishte besueshmëri. Dhe më në fund, ajo u ekzekutua nga mafia".

### KREU I GRUPIT TË LSI

## Vasili: Lu t'i kërkonte qeverisë heqjen e imunitetit të Tahirit

Kryetari i grupit parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili, u shpreh dje se ambasadori amerikan, Donald Lu duhet të mbante një qëndrim të qartë për çështjen "Tahiri". I ftuar në studion e "Repot TV", Vasili tha se Lu duhet t'i kishte kërkuar mazhorancës heqjen e imunitetit të ish-ministrit të Brendshëm. "Lu duhet të kishte mbajtur një qëndrim të qartë, t'i kërkonte mazhorancës heqjen e imunitetit për ish-ministrin. Lu duhet të ishte më i drejtpërdrejtë. Pse duhet të presim janarin për të goditur 'peshqit', bosët e kriminit. Ç'të presim? Nga do ta presim?", tha Vasili. I pyetur nëse LSI pret rezultate konkrete nga operacioni "Forca e Ligjit", Vasili tha se, "zhvillimet dhe faktet e rënda që po dalin çdo ditë s'kanë pse të na çojnë në janar. Duhet një qëndrim i fortë ndaj mazhorancës, boll më me krimin! Në politikë ka qëndrime të qarta, o i voton, o i pengon. Mazhoranca pengoi", tha ai. Vasili u shpreh skeptik edhe për vetingun në polici. "Nuk mund të funksionojë Task Forca e re me njerëz që bëjnë kanabizimin e vendit. Ata nuk mund t'i bëjnë vetingun vetes, pasi janë të njëjtët njerëz. Ndaj refuzoj ta besoj vetëpastroimin e policisë, pasi janë po ata që përmbytën Shqipërinë me drogë", tha ai.



për në BE, duke shtuar se liria e shprehjes është vlerë themelore në BE. Hahn u bëri thirrje gjithë liderëve të Ballkanit Perëndimor që të bëjnë të pamundurën për të shmangur vështirësitë e shumta me të cilat përballen mediat. "Duhet të marrim parasysh dhe presionin poli-

tik, të jemi më realistë, në mënyrë që të kemi zgjidhje lidhur me çështjet e medias", tha Hahn. Komisioneri i BE-së deklaroi se do të ketë profesionistë nga Bashkimi Evropian, që do të japin kontributin e tyre mbi vështirësitë me të cilat përballen mediat në Ballkanin Perëndimor.

REDAKSIA: Redaktor i Suplementeve dhe Sociale: Rezarta Delisula, Redaktor i Rretheve: Trëndafilë VIŠHA, Redaktor i Kulturës: Fatmira Nikolli, Art Designer: Nevila SAMARXHI.

ADMINISTRATA: Përgjegjëse e Financës: Alma Smokhina 0682074397, Shpërndarja: Elvis Llaka Cel 0682074416, Marketingu: Cel:0682074415-email:marketing@gazetashqiptare.com, ADRESA: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotaktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 Marketingu: Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, Internet: www.balkanweb.com, Email: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, SHTYPUR në "Klasik"Shpk



Komisioneri për Zgjerimin në BE: Vetingu, presim rezultate në fillim të vitit

# Hahn me Ramën: Jeni në rrugën e duhur, por nuk mund të shpërfillim deficitet

*Kryeministri: Shqipëria meriton të hapë negociatat*

Darina Tanushi

Komisioneri për Zgjerimin në BE, Johannes Hahn bëri të qartë dje në Tiranë se Brukseli pret nga Shqipëria rezultatet e para të procesit të vetingut në fillim të vitit që vjen. Gjatë konferencës së përbashkët për mediat, Hahn vlerësoi rrugën në të cilën po ecën vendi. "Një nga rezultatet e para që duhet të kemi për të marrë rekomandimin pozitiv është ai që njihet si procesi i vetingut, i famshmi pra, procesi i vetingut, i cili sapo ka filluar dhe unë pres rezultatet e para t'i shikojmë në fillim të vitit. Ekipi ynë i ONM-së ka filluar të punojë, duke pasur ekspertë, do të thosha nga e gjithë bota, pasi unë i kam takuar ata përpara se të vinin në Tiranë dhe kemi pasur një takim të ngrohtë në Bruksel", u shpreh Hahn. Duke vlerësuar ekspertizën e gjyqtarëve, Hahn tha: "Jam i sigurt që e gjithë kjo përvojë dhe dije do të ketë një ndikim shumë pozitiv dhe në sajë të saj, ne do të shikojmë shumë shpejt edhe rezultatet e para". "Po ashtu, këtu kemi të bëjmë edhe me ecurinë, progresin, me ato që njihen si 5 prioritetet, apo përparësitë kyçe. Është shumë e rëndësishme që të konsolidohen arritjet e bëra deri më tash dhe po ashtu, për të ecur përpara në këto fusha. Të gjitha këto, për mendimin tim, janë në rrugën e duhur. Do të thosha që është një gjë, të cilën unë do të dëshiroja ta theksoj, që në vlerësimin tonë, Shqipëria është në rrugëtimin e duhur", vlerësoi komisioneri i BE-së. Por, Hahn theksoi se mund të bëhet më shumë për të treguar "ecurinë, progresin, psh., sa i përket luftës kundër kultivimit dhe trafikimit të drogës, apo për uljen në mënyrë të konsiderueshme të numrit të azilkërkuesve në BE. E kjo është një arritje tjetër e madhe. Është e rëndësishme që edhe të ndryshohen disa deficitet në reputacion. Ato ekzistojnë dhe nuk ka kuptim që ne t'i shpërfillim, por është e rëndësishme që të merremi me to, të përballemi me to dhe jo na bashkon në përpjekjet tona të përbashkëta për të pasur ecurinë e duhur, për të bërë progres", u shpreh komisioneri. Ndërkohë, gjatë fjalës së tij në këtë konferencë, kryeministri shqiptar, Edi Rama kërkoi hapjen e ne-



Komisioneri për Zgjerimin në BE, Johannes Hahn

gociatave, duke thënë se, "sot jemi në kushtet kur nga njëra anë mund ta themi me plot gojë që Shqipëria meriton të hapë negociatat, për sa na takon dhe nga ana tjetër, pavarësisht se si dhe qysh procesi do të zhvillohet, ne do vazhdojmë të konsolidojmë pozicionin tonë lidhur me këtë aspiratë të të gjithë shqiptarëve. Jemi të inkurajuar edhe nga zhvillimet e fundit, që në një farë mënyre po e kthejnë erën në favor të rrugëtimin tonë evropian, duke sjellë edhe mesazhet inkurajuese për vendet tona nga presidenti Juncker, të cilin me shumë kënaqësi do ta takoj në fillim të dhjetorit, pas ftesës së marrë ditën e djeshme", njoftoi Rama.

Kryeministri falënderoi komisionerin Hahn për mbështetjen e posaçme "në një proces, ku ne sigurisht na takon të provojmë progresin me fakte". Komisioneri Hahn, në përgjigje edhe të pyetjeve të gazetarëve u shpreh dje se raporti për Shqipërinë nuk është shtyrë dhe se objektivi i komisionit është që ai të dalë në pranverë. Ai theksoi sërish se, "ka ecuri apo progres sinjifikativ. Por gjithnjë në jetë, puna vjen tek momenti i duhur". Komisioneri Hahn u shpreh ndër të tjera se, "vendet e rajonit, nëse janë shtete anëtare, apo vende kandidatë për anëtarësim në Bashkimin Evropian, duhet të ndihmojnë dhe jo ta bllokojnë ecurinë e njëri-tjetrit".

**ANTIKANABISI**  
Kreu i qeverisë bëri të ditur dje se kishte diskutuar me Hahn "për suksesin e qartë të luftës kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit, një sukses i mishëruar në raportin e dalë pas monitorimit të qenësishëm të Garda di Finanza". "Lufta nis në fazën e dytë, për të cilën ndamë me Hahn objektivat dhe ambicien tonë, si dhe hapat për t'ia dalë me sukses me Task Forcën Speciale të policisë", tha Rama.

**KËSHILLTARI KROAT**

Kryeministri Rama u pyet dje nëse ish-kryeministri kroat, Zoran Mihajlovic është këshilltar i tij, ai u shpreh se "kur bëhet fjalë për Zoranin, është një mik i madh. I kam kërkuar këshillim kur ka qenë kryeministër dhe do i kërkoj këshillim sa herë që ta takoj. Më duhet t'ju them që ai është kaq i mirë me mua, sepse asnjëherë nuk është i vonë, kur jep këshillat e tij".



Komisioneri i BE, mëngjes pune me ministrin e Jashtëm

## Bushati: Arritjet, bazë solide për çeljen e negociatave me BE

Progresi i reformës në drejtësi është element kyç për konsolidimin e shtetit ligjor në Shqipëri", u shpreh dje komisioneri Hahn në një mëngjes pune me ministrin për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati. Hahn vlerësoi vazhdimin e progresit të qëndrueshëm të Shqipërisë në zbatimin e prioritetëve kyç për hapjen e negociatave të anëtarësimit. Sipas njoftimit të Ministrisë së Jashtme, ministri Bushati u shpreh se, "vizita e komisionerit vjen në një moment tepër të rëndësishëm për Shqipërinë. Pas rekomandimit të Komisionit Evropian për hapjen e negociatave të anëtarësimit në varësi të progresit në zbatimin e reformës së gjyqësorit dhe procesit të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në veçanti, Shqipëria e ka lanuar tashmë procesin e vetingut". Ministri e informoi komisionerin edhe mbi hapat konkretë të ndërmarrura nga qeveria shqiptare në përbushje të të gjitha prioritetëve të anëtarësimit dhe konfirmoi vendosmërinë për progres të mëtejshëm. "Këto arritje përbëjnë një bazë solide për çeljen e bisedimeve të anëtarësimit midis Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian", nënvizoi ministri. Hahn vlerësoi linjëzimin e politikës së jashtme të Shqipërisë me Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë të Bashkimit Evropian, si dhe rolin proaktiv të Shqipërisë për nxitjen e bashkëpunimit rajonal dhe të marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë.

**TAKIMI I KRETËS**



**PDIU: Bushati të mos kthehet si Dhimitri i axhendës së ministrit Kotzias**

Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet vlerëson përmes një deklaratë se takimi i Kretës mes ministrave të Jashtëm të Shqipërisë dhe Greqisë përbën një mundësi të veçantë për trajtimin tërësor të tërësisë së çështjeve mes dy vendeve, duke shpalosur mbi tavolinë të gjitha çështjet e pazgjidhura. "I kujtojmë z. Bushati rezultatet për çështjen çame të Kuvendit të Shqipërisë, të miratuar në vitin 2004, si një dokument detyrues për politikën e jashtme. Me çështjen e shqiptarëve të Çamërisë nuk mund të bëhet asnjë koncesion, sepse detyrimi i reciprociteti janë detyrim për politikën tonë të jashtme". "Z. Bushati ka detyrimin moral, politik dhe kombëtar të jetë ministri, që çështjen çame ta kanalizojë në rrugën e zgjidhjes për t'u kthyer nga Kreta si Ditmiri i politikës sonë të jashtme dhe jo si Dhimitri i axhendës së ministrit Kotzias", thuhet në reagim.

## Shefja e ONM-së, Calavera: Vetingu, ndikim në luftën ndaj krimit e korrupsionit

Gjatë një prononcimi për "News 24" dhe "BalkanWeb", shefja e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM) Genovefa Ruiz ka folur për procesin e vetingut, pjesë e reformës në drejtësi. Ajo tha se zbatimi i vetingut do të sjellë një gjyqësor funksional dhe do ketë ndikim në luftën ndaj krimit dhe korrupsionit në Shqipëri. "Vetingu do sjellë një gjyqësor më funksional dhe do ketë ndikim në luftën e korrupsionit", - tha Calavera. Procesi është ende në fazën e ngritjes së institucioneve të reja, plotësimin e tyre me stafet përkatëse, ndërkohë që komisionerët janë tashmë të votuar edhe nga parlamenti. Vëzhguesit ndërkombëtarë do të asistojnë gjatë këtij procesi, i cili siç deklarohet edhe nga kryeministri, do të nisë të japë efektet e para në janar të vitit që vjen. Do të ketë një skanim të të gjithë trupit gjyqësor dhe prokurorëve për të lënë në fund vetëm ata që do të kalojnë skanerin profesional, por edhe të pasuror, vënë gjatë viteve të punës së tyre në drejtësi. Në hapje të godinës së re të vetingut dy drejtueset, kryetarja e Kolegjit të Apelimit, Natasha Mulaj dhe kryetarja e Komisionit të Kualifikimit, Genta Tafa kanë premtuar se drejtësia do të bëhet me çdo kusht.



## KUVENDI DEBATI

"Rama krijoi narkoshtetin, gruaja e Tahirit po shumëfishon dyshimin"

# Berisha në Kuvend: Tahiri i dërgoi Ramës 3 milionë euro në zyrë

"Ministri mori 100 mijë euro, Llalla ta hetojë"

Valentina Madani

Ish-kryeministri Sali Berisha akuzoi dje në Kuvend kryeministrin Edi Rama dhe ish-ministrin e Brendshëm, Saimir Tahiri se janë të përfshirë në trafikun e drogës. Berisha deklaroi se pas rënies së avionit me drogë në Ishëm, Tahiri për të mos u shkarkuar nga detyra si ministër, i ka dërguar Ramës në zyrë 3 milionë euro. Ish-kreu i PD përmendi se opozita ka e denoncuar vazhdimisht Tahirin dhe trafikun e drogës, por akuzat janë injoruar nga kryeministri Edi Rama. "Po ju drejtohem juve socialistë, që nuk jeni të kanalizuar. Juve që nuk e shikoni të ardhmen me krim. Unë ju drejtohem juve sot i detyruar, sepse ata të cilët duhet të ishin këtu, kanë një javë që fshihen. Ata po fshihen se kanë mashtruar për shumë vite në këtë sallë dhe kudo dhe kanë frikë nga vetja e tyre. A nuk e kemi denoncuar në Saimir Trafikun, se në vitin 2013 ishte i pari që importoi skafin. Edi Rama nuk e mori parasysh, do t'i jepte atij portofolin më të rëndësishëm. A nuk jemi ne që denoncuan pasi oficeri Zagani zbuloi lidhjen me Habilajt. Ishte makina me targa e tretë më e rëndësishme në vend, por Edi Rama e mbrojti përsëri. A i shpalli ministrin më të suksesshëm. A nuk jemi ne që denoncuan avionët me drogë? Cila ishte përgjigja e Ramës? Halucinacione dhe mushkonjat ju duken avion. A nuk ishte opozita që denoncoi se në Ishëm ra avioni? Por jo vetëm në Ishëm. Edi Rama përgatiti shkarkimin. I dërgoi 3 milionë euro në zyrë Saimir Tahiri Edi Ramës. Saimir Tahiri nuk u shkarkua. Me qindra herë denoncuan që vendi po mbushet me kanabis", deklaroi z.Berisha. Ish-kryeministri Sali Berisha akuzoi bashkëshorten e Saimir Tahirit se po prish provat për ish-ministrin në zyrën e tij në Gardë. "Shikoni sa prova i ka prishur Tahiri gjatë kësaj periudhe, a nuk po vrapon e



Ish-kryeministri Sali Berisha

## Berisha: Je bandit dhe polic. Ndreu: Nuk e njoh drogën

Ish-kryeministri Sali Berisha iu drejtua dje në Kuvend deputetit socialist, Ndreu: "Pjerin, nuk kam asnjë vërejtje për familjen tendë, por ti je fatqësia e saj. Je edhe bandit, edhe polic". Por, deputeti Ndreu iu përgjigj akuzave të ish-kryeministrit Sali Berisha lidhur me patentat e Tahirit për mjete lundrimi. "Nuk e njoh drogën dhe nuk jam marr me drogë. Unë kam kap ata që janë marrë me drogë dhe ti më ke përgëzuar edhe vetë. As unë dhe as familja deri në brez si nga mua, edhe nga gruaja nuk janë marrë me drogë. Vëllai im nuk ka asnjë lidhje me atë patentë që është e ligjshme. Dokumentet janë bërë në 2011. Ke talentin tënd të gjenjshtrës dhe të shkollës, por mos e lësho në dorë të



Deputeti i PS-së, Pjerin Ndreu

kalamajve se e kanë deforuar", tha deputeti Ndreu. Berisha akuzoi Paulin Ndreu, vëllain e deputetit, se ka lëshuar patentat për ish-ministrin e Brendshëm. Por në replikë, Pjerin Ndreu tha se dokumentet janë lëshuar gjatë kohës së qeverisë "Berisha", ndërsa shtoi se vëllai

s'kishte asgjë dosja, por për 850 mijë euro dhe dy patentat e jahtit, a mund të më thonë pse nuk e çel gojën Saimiri? Por Edi Rama pse nuk flet për të", theksoi z.Berisha. Më herët ish-kryeministri Sali Berisha denoncoi se ministri Damian Gjiku ka marrë 100 mijë euro dhe ka emëruar një të dyshuar për vrasje

### DENONCIMI

Deputeti demokrat, Ervin Salianji publikoi dje vendimet e gjykatës, të cilat kanë rrëzuar pretendimin e qeverisë që familjarët e tij duhet të paguanin 154.762 KWH ose afërsisht 30 milionë lekë për një muaj.

### SPIROPALI

"Kur isha e vogël, në vitet '90-'91, kishim simpati për Berishën. Ashtu e vogël, përpara ekranit edhe ngrija dy gishtat", tha Spiropali. Ajo i këshilloi Berishës që në fund të karrierës së tij, energjitë, veprat të mos i kthejë në logje Kuvendi. 'Hiqni dorë nga këto dhe ndoshta do mbaheni mend për fillimet tuaja', -tha ajo.

i tij nuk ka asnjë lidhje me akuzat e ish-kryeministrit. "Vëllai im nuk ka lidhje në lëshimin e patentave të Tahirit. Patentat e tij janë të ligjshme, po, po të ligjshme. Dokumentet janë bërë në kohën e qeverisë tënde të famshme, në 2010-2011", tha deputeti i PS.

si drejtor tek Aviacioni Civil. Berisha i kërkoi prokurorisë që të hetojë për këtë rast. "Përsëritjeje, në Ministrinë e Infrastrukturasë u zhvillua konkursi për Drejtorinë e Aviacionit Civil. Ky konkurs i stisur përfundoi duke nxjerrë fitues vrasësin e një nëne edhe dy fëmijëve të vegjël të karburantit i babait të tij në



Gjatë një seance parlamentare

### GRIDA DUMA

"Nëse kanabis prodhon para, nuk mund të shajmë pse fshatarët japin me qira tokat bujqësore. Kur diskutohet për legalizimin e drogave, nëse burimet prodhojnë para, atëherë para prodhon më tepër nga ai produkt. Jo rrallëherë gjendemi para shqiptarëve, që thonë vetë e ka fajin ky popull pse nuk ngrihet, pse nuk reagon kur bëhen padrejtësi", tha deputetja e PD-ë.

## Kuvendi voton projektligjet e rendit të ditës edhe me votat e PD-LSI

PD e LSI votuan dje së bashku me deputetët e PS-së projektligjet e rendit të ditës në seancën parlamentare, që zgjati për gati 12 orë. Tri projektligjet kryesore, ai për titujt e pronësisë, rehabilitimi i rrugës së Lumit të Vlorës dhe marrëveshja e interkonjeksionit me Maqedoninë, kanë marrë edhe votat e deputetëve të PD-së e LSI-së, në ndryshim nga seancat e kaluara. Projektligji për titujt e pronësisë mbi tokën bujqësorë u miratua me 103 pro, 3 kundër dhe 7 abstenim, rehabilitimi i rrugës së Lumit të Vlorës mori 113 pro, ndërsa ka rënë në sy abstenimi i Nard Ndokës. Marrëveshja për interkonjeksionin me Maqedoninë u votua me 113 vota pro, asnjë kundër. Deputetët e opozitës janë larguar nga seanca pas votimit të këtyre projektligjeve, duke mosngritur kartonët për të gjitha projektligjet e rendit të ditës.

### VOTIMI NË KUVEND

- Projektligji për titujt e pronësisë mbi tokën bujqësorë - 103 pro, 3 kundër, 7 abstenim.
- Rehabilitimi i rrugës së Lumit të Vlorës - 113 pro, 1 abstenim (Nard Ndoka).
- Marrëveshja për interkonjeksionin me Maqedoninë - 113 vota pro, asnjë kundër.

Golem!", shkruhet ndër të tjera në postimin e Berishës. Po dje z.Berisha akuzoi dje kryeministrin Edi Rama se ka miratuar vendimin për shpopullimin e Luginës së Preshevës. Z.Berisha tha se regjimi i Vuçiç po zëvendëson udhëheqësit shqiptarë legjitimë me refugiatë nga territore të tjera, jo vetëm të Ball-

kanit. Ai foli edhe për çështjen e Kumanovës dhe vendimin e dhënë ndaj të arrestuarve tek "Lagja e Trimave" dhe kërkoi hetim ndërkomëtar. Ish-kryeministri akuzoi se qeveria "Rama" ka zero interes kombëtar, ndërsa sipas tij, ka interes vetëm pasurimim e paligjshëm të klikës në pushtet.



“PS ka njerëz të ndershëm, të bashkohemi kundër pushtetit të krimit”

# Paralajmërimi i Bashës: Së shpejti në Shqipëri s’do ketë stabilitet

“Sejdini ka agjenci doganore, po hetohet për trafik droge”

Valentina Madani

**K**reu i opozitës, Lulzim Basha nga foltorja e parlamentit u bëri dje thirrje të gjithë qytetarëve shqiptarë pa dallime partiake, por edhe spektrit politik, të bashkohen kundër së keqes që sipas tij po mban peng vendin. Ai paralajmëroi se shumë shpejt do të vijë dita që në Shqipëri s’do të ketë stabilitet ndaj ai ftoi të majtë e të djathtë të bashkohen kundër kryeministrit Rama dhe atij që ai e quan pushteti i krimit. “Ju që deri dje besuat tek Edi Rama, ju që deri më sot u joshët, duhet të shikoni të vërtetën. E vërteta është se në Shqipëri nuk do ketë rend dhe demokraci me Edi Ramën. Shqipëria ka njerëz të ndershëm. Vetë PS ka njerëz të ndershëm dhe për PS është e pafalshme që ia ka dorëzuar pushtetin Edi Ramës. PS duhet të shohë të vërtetën në sy”, deklaroi Basha nga foltorja e parlamentit. Ai tha më tej se Tahiri vijon të jetë i lirë, pasi nuk ka pasur reagim të unifikuar kundër krimit. “E vërteta tjetër e madhe është se e vetmja arsye që Tahiri është i lirë është se ne nuk kemi reaguar. Kur të jemi të gjithë bashkë përballë Edi Ramës përtej paragjyqimeve, pushteti i Ramës merr fund dhe bashkë me të edhe pushteti i krimit, kjo ditë do të vijë shpejt. E vërteta është e thjeshtë: në Shqipëri nuk do ketë as stabilitet, as rend, as drejtësi, as liri, as demokraci, as përparim me Edi Ramën në krye të qeverisë”, tha z.Basha.



Kreu i opozitës, Lulzim Basha

**LARGIMI**

“E vërteta është e thjeshtë: në Shqipëri nuk do ketë as stabilitet, as rend, as drejtësi, as liri, as demokraci, as përparim me Edi Ramën në krye të qeverisë”, tha z.Basha.

**KREU I OPOZITES**

“E vërteta tjetër e madhe është se e vetmja arsye që Tahiri është i lirë është se ne nuk kemi reaguar. Kur të jemi të gjithë bashkë përballë Edi Ramës përtej paragjyqimeve, pushteti i Ramës merr fund dhe bashkë me të edhe pushteti i krimit, kjo ditë do të vijë shpejt.



Fate Velaj

**Letra e qytetarëve e Vlorës në Kuvend**

**PS, Velaj: Gruaja e Bashës, kushëriri e Habilajve**

Deputeti socialist në qarkun e Vlorës, Fate Velaj, akuzoi dje kreun e PD, Lulzim Basha, si të lidhur me grupin kriminal Habilaj. Gjatë fjalës së tij në seancën plenare, Velaj lexoi letrën e qytetarëve të zonës së tij elektorale, ku zbuloi disa të dhëna të papublikuara më parë. Në letrë flitej për lidhjet farefisnore të gruas së Bashës me Habilajt, ndihmën ndaj tyre në periudhën e piramidave dhe lidhjet e tij me ta kur ishte ministër i Brendshëm. Sipas ligjëvënësit të PS, PD ka ndihmuar Habilajt që në kohën e piramidave të famshme me anë të piramidës “Alimuça”. Ndërsa tjetra, në letrën e qytetarëve thuhet se bashkëshortja e Bashës është kushëriri e një personi me mbiemrin Alimuça dhe që është edhe kushëri i Habilajve. Në letrën e lexuar nga Velaj në Kuvend, qytetarët shprehën se, “Basha i njëjti Habilajt që kur ishte ministër i Brendshëm dhe ata e bridhnin detin ngarkuar sikur ta kishin të babait. Ç’pati Zaganin që përmendi një qokë të policisë së Durrësit për ta kur ti ishte në pushtet Lulzim?”, - vazhdon letra. Në fund të letrës qytetarët shprehën se e njohin mirë historinë dhe se pasi të përgjigjet Basha për këto, kanë edhe ca pyetje të tjera. Tani radhën e ka Basha të tregojë lidhjet e tij, shkruhet në letrën e lexuar nga deputeti Velaj.

**Balla, Bashës: Shkarko Kapllanajn, siç bëme ne me Roshin**

**K**reu i grupit parlamentar socialist, Taulant Balla, iu kundërpërgjigj kreut të PD-së, Lulzim Basha lidhur me akuzat për krimin, ndërsa i kërkoi që të largojë kryebashkiakun e Mallakastrës. Në fjalën e tij në Kuvend, z.Balla deklaroi se Basha di vetëm të gënjejë dhe nuk di t’u dalë problemeve ballë. “Si mund të jesh kaq gënjeshtar, pasi Klement Ballli nuk ka lidhje me Partinë Socialiste. Është i LSI-së. Nuk ka asnjë lidhje me ne, mos gënje më. Të njëjtën gjë bëre me Agron Kapllanajn, pasi po mban në detyrë një kryebashkiak të korruptuar dhe të dënuar me vjedhje. Shkarkoni Kapllanajn dhe hajde të bëjmë zgjedhje, të matemi përsëri. Mund t’i bëjmë për një muaj ju të gjithë dhe ne vetëm”, - deklaroi z. Balla.



**AKUZA**

Kreu i opozitës, Lulzim Basha, akuzoi dje në Kuvend se një agjenci në pronësi të kryebashkiakut të Elbasanit, Qazim Sejдини, po hetohet për trafik droge. Gjatë seancës së djeshme plenare, z.Basha hodhi akuzë edhe në adresë të kryebashkiakut të Durrësit, Vangjush Dako. “Jo rastësisht Qazim Sejдини ka një agjenci doganore që po hetohet për trafik droge, jo rastësisht Vangjush Dako është kryebashkiak, biznesmen dhe kryekapobanda e Durrësit. Çdo gjë do të thellohet me projektin ‘1 miliard’, një projekt kriminal që do shpikrë në një, krimin, biznesin dhe

politikën. Projekti ‘1 miliard’ është rruga e konsolidimit të konsorciumit politiko-kriminal, i cili ka përsëritur të shtojë Shqipërinë për dekada. Forma më e rrezikshme e krimit nuk është një grup kriminelësh me armë në dorë, që grabisin me forcë apo transportojnë drogën, por kur bëhen bashkë kriminelit, qeveritari dhe bankieri dhe bien në ujdj për të plaçkitur dhe kontrolluar një vend të tërë. Kjo është faza ku ka hyrë krimi në Shqipëri”, tha z.Basha.

**KRIMI**

Kryetari i PD, Basha u shpreh nga foltorja e Kuvendit

se Rama dhe Xhafaj po përgatisin një plan për të pasur në dorë prokurorinë. Në një kohë kur mandati i kryeprokurorit Adriatik Llalla përfundon pas një muaji, Basha thotë se ka një skenar për prokurori private të Ramës dhe ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj. Sipas tij, organi i akuzës do përdoret nga kryeministri si mjet shantazi dhe kërcënim për kundërshtarët. “Ne bëme një betejë për reformën në drejtësi që të mos bëhet ashtu siç donte Edi Rama. Imagjino sikur Byroja e Hetimit të ishte në varësi të

MB, në varësi të Tahirit, do ishte cenim i sigurisë kombëtare. Tani që skandali ‘Tahiri-Habilaj’ e ka nxjerrë zbuluar, kërkohet të ketë edhe prokurorinë private. Nën drejtimin politik të Fatmir Xhafaj, kjo do të ishte një mburojë për të dhe shpurën e tij dhe një mashë për të kërcënuar, shantazhuar dhe persekutuar këdo që bëhet pengesë për të dhe kupolën e tij. Që policët e ndershëm të bëjnë punën e tyre, duhet që qeverisja të çlirohet nga politikanët që i shërbejnë krimit. Njerëz si Saimir Tahiri e kanë vendin në burg dhe jo në krye të Ministrisë së Brendshme. Këta njerëz duhet të kenë në duar pranget e drejtësisë dhe jo çelësat e pushtetit. Nëse doni ta kuptoni këtë, imagjino SHKB-në e Tahirit, që rrembyen në mes të natës Dritan Zaganin dhe e mbyllën në qeli për Habilajn”, tha Basha. Sipas tij, “kanabizimi i vendit ka qenë një projekt i qëllimshëm antikomëtar i Edi Ramës”. “Në këtë projekt ai dërdhi gjithë urrejtjen dhe mllëfjen që ka ndaj shqiptarëve. Kriminelët me pushtet dhe droga ishte hakmarrja ndaj të gjithëve e një njeriu të dështuar, për të cilën ai fajëson këdo, familjen, shoqërinë, atdheun, por kurrë veten e tij. Prandaj, të lësh fatet e vendit në duart e Edi Ramës do të thotë të lësh Shqipërinë në dorë të krimit dhe të shkatërrimit”. Duke cituar ish-prokurorin italian, Paolo Borsellino, kreu i PD-së bëri thirrje për një bashkim të madh për të larguar Ramën nga zyra e kryeministrit.

Ndryshon Buxheti 2017, miratohet fondi për shpërblimin e pensionistëve

Ornela Manjani

# Qeveria, pensionistët 1.8 miliardë lekë shpërblim për Vit të Ri

## Bonusi për fëmijët, pagesat për të lindurit nga viti 2008

Qeveria ndryshon buxhetin e vitit 2017. Në aktin normativ të dorëzuar dje në Kuvend është përcaktuar fondi për bonusin e pensionistëve për festat e fundvitit dhe shuma që do të paguhet për fëmijët e lindur nga vitit 2008 e në vazhdim. Në relacionin që i bashkëlidhet aktit evidentohet nevoja për një ndërhyrje të tillë në kushtet e ristrukturimit të institucioneve. Krahas rialokimit të disa fondeve, në relacion dalin edhe projektet që janë lënë për t'u zbatuar në javët e mbetura të këtij viti. Me ndërhyrjen e realizuar në buxhet, qeveria ka rritur me 1.8 miliardë lekë kontributin nga sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, si rrjedhojë e performancës së lartë në mbledhjen e tyre gjatë periudhës janar-shtator 2017. Kjo rritje do të shkojë tërësisht për bonusin e pensionistëve, me një efekt neutral për buxhetin e shtetit. Një ndërhyrje tjetër është ajo e rritjes me 200 milionë lekë të fondit për kompensimin e fëmijëve. Që prej vitit 2008, qeveria ka vendosur një shpërblim 5 mijë lekë për fëmijët e lindur, ashtu sikurse ka edhe një serë përfitimsh të tjera për këtë qëllim, të cilat prej vitesh kanë krijuar borxh për shkak se nuk janë shlyer. E me këtë vendim, qeveria parashikon të shlyejë detyrimet e prapambetura, brenda këtij viti.



Foto ilustruese

### SHPËRBLIMI

Që prej vitit 2008, qeveria ka vendosur një shpërblim 5 mijë lekë për fëmijët e lindur, ashtu sikurse ka edhe një serë përfitimsh të tjera për këtë qëllim, të cilat prej vitesh kanë krijuar borxh për shkak se nuk janë shlyer. E me këtë vendim, qeveria parashikon të shlyejë detyrimet e prapambetura, brenda këtij viti.

### RRITJA E PENSIONEVE

Në zërat e buxhetit të shtetit tashmë është bërë traditë që të ketë një zë të veçantë për politika të reja

pagash dhe pensione. Në projektbuxhetin e vitit të ardhshëm tashmë për rritje pagash është parashikuar një fond prej 1 miliardë lekë. Ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj u shpreh se mbështetjen më të madhe do e kenë sektorët e arsimit dhe shëndetësisë. Ndërsa në lidhje me rritjen e pensioneve, ku është parashikuar një fond prej 1.8 miliardë lekë, rritja do nisë nga muaji maj i vitit të ardhshëm. Në vitin 2017 qeveria vendosi të rrisë pagat, pas një ndërprerje të kësaj politike për 3 vite. Kështu nga kjo rritje përfituan 110 mijë persona, për

të cilët u akordua një fond nga buxheti i shtetit prej 5,5 miliardë lekë.

### NDRYSHIMET

Ministria e Financave dhe Ekonomisë propozon këtë akt normativ me bindjen se ndryshimet e paraqitura sigurojnë rritjen e tre objektivave të rëndësishëm: garantimin e ofrimit të shërbimeve publike, rritjen e frytshmërisë së përdorimit të burimeve publike, rritjen e sigurisë në realizimin e treguesve të buxhetit. "Bazuar në performancën makro-fiskale e buxhetore të 10-mujorit janar-tetor 2017, si dhe në parashikimin e prishëm të këtyre treguesve

deri në fund të këtij viti buxhetor, akti normativ konsiston në: ruajtjen e parame-trave kryesore të buxhetit të miratuar në fillim të vitit; deficitit buxhetor mbetet i pandryshuar, ndërkohe që të ardhurat dhe shpenzimet e buxhetit rriten në të dyja kahet me rreth 4,5 miliardë lekë; rialokime brenda zërave të shpenzimeve të buxhetit, me qëllim akomodimin e prioritetve të qeverisë së re, rritjen e efikasitetit të treguesve kryesorë makrobuxhetorë, me qëllim arrijtjen e objektivave deri në fund të vitit 2017" thuhet në relacionin e aktit normativ të buxhetit të vitit 2017.

### RISHPËRNDARJA BRENDA ZËRAVE TË SHPENZIMEVE TË BUXHETIT

1. Rialokimi i shpenzimeve kapitale, nga projektet me ecuri të ngadaltë tek ato me ecuri të lartë, në rreth 2.4 miliardë lekë në total (rreth 1.5 miliardë lekë nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve), ku rreth 600 milionë lekë rialokohen në zërin "shpronësime";
2. Rritja me 352 milionë lekë e fondit për kompensimin e ish-të përndjekurve politikë, me qëllim akomodimin e shlyerjes 100% të kështit të tetë dhe të fondit të kategorisë parësore të përfutuesve të gjallë, deri në fund të vitit 2017.
3. Rritja me 200 milionë lekë të shpenzimeve dedikuara kompensimit të lindjes së fëmijëve, me qëllim likuidimin e detyrimeve të krijuara në këtë zë; rritjen me 200 milionë lekë të zërit "Mirëmbajtje rrugore", me qëllim financimin e detyrimeve ekzistuese të kontratave të mirëmbajtjes së akteve kombëtare;
4. Rritja me 150 milionë lekë të buxhetit të Ministrisë së Drejtësisë për rikonstrukcionin e godinës së Kolegjit të Posaçëm të Apelitit;
5. Rritja me 127 milionë lekë të shpenzimeve korrente për të përballuar faturat e përfaqësimit të Shqipërisë në çështjet e arbitrazhit të gjykatave ndërkombëtare, me qëllim evitimin e krijimit të detyrimeve të prapambetura;
6. Rritja me 120 milionë lekë të shpenzimeve të AKSHO-së, me qëllim akomodimin e kështit të radhës së Microsoft-it;
7. Rritja me 100 milionë lekë të buxhetit të Ministrisë së Mbrojtjes, për përmbushjen e një sërë detyrimeve në kuadër të përfaqësimit në NATO;
8. Rritja me 100 milionë lekë e transferitës buxhetore për Radiotelevizionin Shqiptar, për mbulimin e shpenzimeve të implementimit të platformës së dixhitalizimit;
9. Reduktimi me 400 milionë lekë i fondit rezervë për institucionet e vetingut, duke bërë efektiv fillimin e financimit që në buxhetin 2017 të tri institucioneve të reja të tij, përkatësisht Komisionit të Rivlerësimit Kalimtar të Magjistratit; Komisionit të Apelitit të Rivlerësimit Kalimtar dhe Komisionerëve Publikë;
10. Reduktimi me 200 milionë lekë i rezervës për rritjen e pagave, si rrjedhojë e kursimeve pas akomodimit të të gjitha kërkesave të institucioneve buxhetore;

## Të ardhurat nga taksa e pasurisë

# Ndryshimi i llogaritjes do të ndikojë në financat vendore

Ndryshimi i mënyrës së llogaritjes së taksës mbi pasuritë ka ndikuar në buxhetin e pushtetit vendor. Një burim i rëndësishëm të ardhurash për buxhetin vendor përfaqësohet nga ajo nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme. Sipas raportit të publikuar për Financat Vendore, në gjashtë muajt e parë të vitit 2017, të ardhurat nga kjo taksë regjistruan një vlerë prej rreth 2.6 miliardë lekë, në rritje modeste me 2.5% në terma vjetorë. Në të gjitha vitet e marra në analizë, taksa mbi ndërtesat përbën mesatarisht rreth 87.3% dhe të ardhurat nga taksa mbi tokën bujqësore zënë 10.2%, ndaj to-

### LLOGARITJA

Në të gjitha vitet e marra në analizë, taksa mbi ndërtesat përbën mesatarisht rreth 87.8% dhe të ardhurat nga taksa mbi tokën bujqësore zënë 10.2%, ndaj totalit të të ardhurave nga taksa mbi pasuritë e paluajtshme. Kështu në terma vjetorë, të ardhurat nga taksa mbi ndërtesat rezultuan në rreth 2.4 miliardë lekë, në rritje me rreth 5.6% në gjashtë muajt e parë të vitit 2017.

talit të të ardhurave nga taksa mbi pasuritë e paluajtshme. Kështu në terma vjetorë, të ardhurat nga taksa mbi ndërtesat rezultuan në rreth 2.4 miliardë lekë, në rritje me rreth 5.6% në gjashtë

muajt e parë të vitit 2017. Në të kundërt, të ardhurat nga taksa mbi tokën bujqësore shënuan rënie vjetore të theksuar me rreth 20.6% krahasuar me një vit më parë. Taksa e truallit nuk rezultoi

të ketë regjistruar të ardhura në këtë periudhë. Nga analiza e këtij raporti, ky nivel mund të lidhet me problematikat e mungesës pothuajse totale të regjistrave të bazës së taksës dhe taksapaguesve. Aktualisht, qeveria qendrore në këshillimin të vazhdueshëm me Fondin Monetar Ndërkombëtar, ka propozuar reformimin e taksës mbi pasurinë e paluajtshme. Veçanërisht, synohet kalimi nga taksa me bazë fikse (i aplikuar aktualisht), në aplikimin e taksës së ndërtesës mbi vlerën e tregut të pronës.



Në vijim të krijimit të regjistrat qendror të bazës së të dhënave të pasurive të paluajtshme (kadastrës fiskale) dhe reformimit të taksës së

ndërtesës, të ardhurat në buxhetin e njëjës të vetëqeverisjes vendore pritet të pësojnë rritje të ndjeshme.

Sejko: Tregu financiar duhet të zgjerohet, duhet zvogëluar monopoli i bankave

Ornela Manjani

# BSH: Ekonomia po rritet; Meta: Rritja 3.5%, e pamjaftueshme

Ahmetaj: Në vitin 2016 janë 65 mijë vende të reja pune

Governatori i Bankës së Shqipërisë, Gent Sejko deklaroi dje se ekonomia shqiptare po kalon një moment pozitiv, i cili pritet të zgjasë edhe vitin e ardhshëm. "Tremujori i fundit i vitit e gjen ekonominë shqiptare në një situatë ekonomike në përmirësim të vazhdueshëm. Treguesit e rritjes ekonomike dhe punësimit janë në kurbë rritëse dhe pritshmëritë për vitin 2018 janë pozitive. Një tablo pozitive karakterizon edhe stabilitetin financiar të vendit, siç tregohet nga rënia e ndjeshme e kredive të këqija", tha Sejko. Edhe ministri i Financave, Arben Ahmetaj ndan të njëjtin qëndrim. Sipas tij, forcimi i rritjes ekonomike ka rritur të ardhurat e qytetarëve: "Një nga aspektet më pozitive të zhvillimit ekonomik është përgjigjja e tregut të punësimit ndaj rritjes ekonomike. Vetëm në vitin 2016 janë 65 mijë vende të reja pune në ekonomi". Por, Presidenti i Republikës është më i përmbajtur. Iliir Meta tha se rritja aktuale e ekonomisë është e pamjaftueshme për të rritur mirëqënien e pjesës më të madhe të familjeve: "Kthimi i ekonomisë në ekuilibër, duke nënkuptuar një rritje ekonomike afatmesme prej 3.5% është sërish i pamjaftueshëm për të garantuar një efekt të prekshëm mbi shtresat e gjera të shoqërisë. Në këtë kuadër, progresi i reformave strukturorë është jetik për të mbështetur konvergimin e shpejtë ekonomik dhe institucional me vendet e BE".

## BANKAT

Pavarësisht zhvillimeve pozitive në ekonominë shqiptare sistemi financiar, ende mbetet i dominuar nga sistemi bankar dhe zhvillimet e tij. Në raportin e fundit të stabilitetit financiar të Bankës së Shqipërisë, citohet se bankat përfaqësojnë ende rreth 90% të totalit të aktiveve të sistemit financiar, ekuivalent me 92% të PBB-së, ndërkohë që pjesa tjetër e sektorit financiar është e vogël dhe përbën vetëm 10% të totalit të aktiveve të sistemit financiar, u shpreh Governatori Gent Sejko në konferencën vjetore të Bankës së Shqipërisë. Ai tha se Vlerësimet dhe studimet e Bankës së Shqipërisë, por edhe studimet krahasuese të palëve të treta si Fondi Monetar Ndërkombëtar, tregojnë se tregu financiar në Shqipëri ka përhapje dhe shtrirje financiare afër nivelit të ekuilibër të diktuar nga ekonomia dhe konsumatorët shqiptarë. Gjithashtu, treguesit e ndërmjetësimit financiar të shprehur si përqindje ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto, janë në nivele të përafërta me ato të vendeve të tjera të rajonit. Governatori referoi se, mbizotërimi i segmentit bankar, naty-



Governatori Gent Sejko dhe Presidenti Iliir Meta gjatë konferencës vjetore të Bankës së Shqipërisë

shëm ka cuar në një shkallë të lartë përqendrimi të produkteve dhe shërbimeve financiare në favor të tij. Mbi 80% e investimeve të reze-ndenteve në sistemin finan-

ciar janë në formën e depozitave dhe llogarive rrjedhëse. Vetëm pak, mbi 12% janë në formën e letrave me vlerë të qeverisë ndërkohë që pjesa e mbetur, rreth 6.5% janë

## Tarifat përmbartimore - Ministri Ahmetaj premtion uljen e tyre

Ministri i Financave, Arben Ahmetaj, premtion të enjten zgjidhjen e shpejtë të ngërçit të krijuar mes bankave dhe shoqërive përmbartimore, për shkak të rritjes së lartë të tarifave. Duke përsëritur edhe njëherë optimizimin për shëndetin e ekonomisë shqiptare, Ahmetaj tha gjatë konferencës vjetore të Bankës së Shqipërisë se ecuria e kreditimit ende nuk i përgjigjet ecuresë pozitive të treguesve të tjerë makro. Sipas tij, legjislacioni për tregun financiar do të përmirësohet, ndërsa pengesat për mbledhjen e detyrimeve, siç mund të jenë tarifave e larta përmbartimore, do të korrigjohen. Anulimi i udhëzimit për tarifave e reja përmbartimore u kërkua shprehimisht edhe në deklaratën e fundit të misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar.



investuar në fondet e depozitave dhe ato të pensioneve private. Kjo e fundit përbën vetëm 0.1% të totalit të aktiveve të sistemit financiar. Statistikat tregojnë se num-

ri i kompanive që operojnë në segmentet e tjera të sektorit financiar mbetet i ulët, ndërkohë që aktiviteti i tyre në terma të Prodhimit të Brendshëm apo të tregut fi-

nciar mbetet i papërfillshëm. Për sa më sipër, konkluzioni logjik është se arkitektura e tregut financiar ende nuk mund të konsiderohet e plotë. Instrumentet financiare me maturitet afatgjatë janë të rralla, ndërkohë që ato afatshkurtra jashtë sistemit bankar, janë apatike dhe të fragmentuara, si në produkte ashtu dhe në tregje. Fryt i kësaj arkitekture financiare është një lloj presioni i shtuar mbi sistemin bankar, duke privuar ekonominë nga alternativat e tjera të financimit përtej atyre që ofrojnë bankat, tha Governatori.

## KREDITIMI

Vrojtimet e Bankës së Shqipërisë tregojnë se njësitë mikro, ballafaqohen me pamjaftueshmëri burimesh financiare dhe me akses të kufizuar në kredi. Konkretisht, më shumë se 1/3 e ndërmarrrjeve të intervistuarave vlerëson aksesin e ulët në financim dhe koston që shoqëron atë si shkakun kryesor të mos zgjerimit të vepërimitarisë. Këto njësi mikro që janë kryesisht biznese familjare, kanë më shumë nevojë të bashkëpunojnë me institucionet financiare jobanka, pasi ato hasin vështirësi në përmbushjen e kërkesave që lidhen me kolateralin apo dokumentacionin e hollësishtëm financiar, kushte këto që kërkohen nga bankat. Ky është një tjetër argument që të çon në konkluzionin logjik, se përvëq kapitalëve të veta dhe kredisë bankare, këto ndërmarrrje do të përfitonin shumë nga segmente të tjera të tregut financiar.

## Raporti i Bankës së Shqipërisë

# Rritja e kredisë për korporatat e nxitur nga punët publike

Portofoli i kredisë për biznese ka sfaquar ecuri pozitive në tremujorin e tretë të vitit, raporton Banka e Shqipërisë në një analizë për ecurinë e kredisë në periudhën korrik-shtator. Kushtet monetare lehtësuese, përmirësimi i aktivitetit ekonomik dhe rritja e gatishmërisë së bankave për të financuar segmentin e korporatave dhe nxitur rritjen e portofolit. Megjithatë, kjo rritje mbetet poshtë rritjes mesatare të shënuar për vitin 2016, e kushtëzuar si nga një përjasje e kujdesshme e bankave për lehtësimin e kushteve, ashtu edhe një kërkesë e luhatshme për kredi nga bizneset. Ndërkohë, normat e interesit për kreditë në lekë për bizneset kanë qëndruar

## HUADHENIA

Kredia për likuiditet është rritur me 2 miliardë lekë në këtë tremujor, ndërkohë që mesatarisht ajo ka mbajtur të njëjtin normë tkurrije si një tremujor më parë në 1.9%. Nëse do të merrnim në konsideratë dhe mbicimimin e lekur ndaj valutës, kontributi i kredisë për likuiditetet do të ishte pozitiv për tremujorin e tretë dhe i përmirësuar krahasimisht me një tremujor më parë.

pranë niveleve të ulëta të tremujorit të dytë të vitit dhe ato për kreditë në euro kanë shënuar rënie. Bankat presin që rritja e kërkesës për kredi nga bizneset të vijojë edhe në tremujorin e fundit të vitit, e mbështetur edhe nga lehtësimi i standardeve për këtë segment. Kreditimi i bizneseve nga bankat ka sfaquar ecuri pozitive në tremujorin e tretë të vitit, duke shënuar rritje me 6.2 miliardë nga fundi i muajit

qershor. Gjithashtu, në përmirësim gradual janë edhe normat vjetore të rritjes së këtij portofoli, duke arritur në 2.2% në muajin shtator. Këto zhvillime pozitive kanë reflektuar përmirësimin e aktivitetit ekonomik në vend, uljen e pasigurisë në periudhën pas zgjedhore, si dhe një gatishmëri më të lartë të bankave për t'u përgjigjur kërkesës së shtuar nga ky segment. Zgjerimi i portofolit të kre-



Banka e Shqipërisë

disë për biznese është mbështetur nga kreditimi në lekë i këtij segmenti. Norma vjetore e rritjes së portofolit të kredisë në lekë për biznese shënoi përmirësim në 9.1%, ndërsa kreditimi në valutë për këtë grup zbuli normat e tkurrijës. Megjithatë, kjo e fundit reflekton edhe mbicimimin e lekur ndaj monedhave kryesore, i cili ka vazhduar edhe në tremujorin e tretë. Nëse do të merrej në konsideratë edhe ky

mbicim, tremujori i tretë tregon për përmirësim të aktivitetit kredites në valutë të bizneseve dhe rritja e këtij portofoli do të kalonte në terren pozitiv. Raporti i kredisë në lekë ndaj totalit të kredisë për biznese shënoi përmirësim në 38.4%, ose 1.4% më shumë se në fund të vitit 2016. Në raport me PBB-në, kredia për biznese ruajti të njëjtin nivel si një tremujor më parë, në 24.6%.

Sekuestrohen bilancet e kompanive të 25-vjeçarit dhe të atit

# "Saimir Tahiri ka përdorur makinën e biznesmenit vlonjat, Orest Sota"

Prokuroria nis hetimin pasuror për ish-ministrin e Brendshëm

Prokuroria e Krimeve të Rënda vijon veri fikimet për lidhjet e mundshme mes ish-ministrit të Brendshëm, Saimir Tahiri dhe biznesmenit Orest Sota të arrestuar disa ditë më parë. Shkak për nisjen e hetimit është bërë gjetja e patentave të Tahirit për mjete lundrimi në makinën e biznesmenit Sota. Hetuesit kryen verifikimet në sistemin TIMS për hyrjedaljet e Sotës dhe ish-ministrit të Brendshëm, për të cilën kreu i PD-së, Lulzim Basha deklaroi se kanë udhëtuar së bashku jashtë vendit. Prokuroria ka ngritur pretendimin se nga pika e Muriqanit ka dalë me makinën e tij, Orest Sota. Po të njëjtat burime pretendojnë se kanë zbuluar që nga kjo pikë në të njëjtën ditë ka dalë me makinën e tij edhe ish-ministri i Brendshëm, Saimir Tahiri, deklaroi "A1 Report". Ndërkohë ngrihet edhe një tjetër pretendim nga prokurorët se nga verifikimet në TIMS është zbuluar se në kthim, ish-ministri i Brendshëm, Tahiri ka hyrë në territorin shqiptar nga pika kufitare e Muriqanit, duke përdorur automjetin në pronësi të Orest Sotës. Ndërsa ky i fundit sipas burimeve nga prokuroria, ka hyrë në territorin shqiptar nga pika e Muriqanit duke përdorur automjetin e Saimir Tahirit.

## HETIMI PASUROR

Prokuroria e Krimeve të Rënda nisi zyrtarisht këtë të enjte hetimin pasuror për ish-ministrin e Brendshëm, Saimir Tahiri, i cili dyshohet për përfshirje në grupin kriminal "Habilaj". Burime pranë organit të akuzës thanë se me qëllim verifikimit e ligjshmërisë së pasurisë së personit nën hetim dhe personave të lidhur me të, u janë dërguar shkresa bankave të nivelit të dytë, Tatimeve, Doganave dhe Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Prokurorët pritet të marrin dëshminë e shoferit të Tahirit, me të cilin 25-vjeçari ka deklaruar se ka miqësi dhe mund të jetë ai personi që ka harruar dokumentet



Saimir Tahiri



Orest Sota

## VERIFIKIMI

Nga verifikimet në TIMS është zbuluar se ish-ministri i Brendshëm, Tahiri ka hyrë në territorin shqiptar nga pika kufitare e Muriqanit, duke përdorur automjetin në pronësi të Orest Sotës. Ndërsa ky i fundit ka hyrë në territorin shqiptar duke përdorur automjetin e Saimir Tahirit.

në automjetet. Gjithashtu, Krimet e Rënda sekuestrohen bilancet e kompanive që administrohen nga 25-vjeçari Orest Sota dhe babai i tij, Lefter Sota. Këto bilance vjetrore do monitorohen nga ekspertë kontabël, të cilët pritet të paraqesin një raport financiar në prokurori, duke rakorduar të ardhurat dhe shpenzimet e bizneseve të familjes Sota. Nga këto bilance do të kuptohet nëse kompanitë e familjes Sota kanë gënjeneruar të ardhura që të justifikojnë shumën prej 863.100 mijë euro ose jo.

## Hetimi për destinacionin final të shumës së parave

Arrestimi i biznesmenit me 863 mijë euro dhe patentat e Tahirit. Altin Qato, vizitë tek Krimet e Rënda

Drejtimesit e Krimeve të Rënda, të cilët po drejtojnë hetimin ndaj 25-vjeçarit Orest Sota dhe ish-ministrit të Brendshëm, Saimir Tahiri kanë thirrur dje në mesditë drejtorin e komanduar të policisë së Qarkut Elbasan, Altin Qato. Bëhet me dije se takimi mes drejtorit të policisë dhe prokurorëve të Krimeve të Rënda ka nisur në orën 14:00. Altin Qato dhe prokurorët janë takuar për të koordinuar veprimet e prokurorisë me policinë në lidhje me hetimet. Mësohet se gjatë takimit u zhvillua një analizë lidhur me veprimet hetimore që do kryhen për këtë çështje në ditët në vijim, pyetja e personave dhe punimi në rrugë operative për të mundësuar se cili ka



Altin Qato

qenë destinacioni final i shumës prej 863.100 mijë euro. Burime të rezervuara thanë se mes Qatos dhe grupit të prokurorëve është diskutuar edhe një tjetër çështje e rëndësishme, për të cilën nuk dhanë detaje.

Kujtojmë se biznesmeni Orest Sota tha se shumën e parave e kishte për të shlyer disa pagesa në një kompani, ndërsa patentat i kishte harruar shoferi i Tahirit, me të cilin ai kishte miqësi.

## SHKURT

**Kapet grupi i "skifterëve" në Tiranë, zbulohet lista e vjedhjeve**

TIRANË - Policia e Tiranës ka finalizuar me sukses një operacion, ku janë arrestuar 4 persona, pasi akuzohen se janë autorë të 6 grabitjeve të dokumentuara, kryesisht të banesave. Specialistët për Hetimin e Krimet në komisarariat nr.5 Tiranë kanë bërë të mundur zbardhjen dhe dokumentimin me prova ligjore të autorësisë për 6 raste të vjedhjes së banesave dhe të pronës, raste këto të ndodhura muajt e fundit. Si rezultat janë kapur dhe ndaluar shtetasit S.D, 22 vjeç, banues në Kamëz; A.Sh., 35 vjeç., banues në Kodër Kamëz; F.Z, 42 vjeç, banues në Bathore. Gjithashtu, në bashkëpunim me komisarariatin e policisë nr. 3 Tiranë, më datën 06.11.2017, është bërë arrestimi në flagrancë i shtetasit V.A., 33 vjeç, banues në Kamëz, pasi u kap në flagrancë me një sasi lënde narkotike. Personat e lartpërmendur u ndaluan, pasi në bashkëpunim me njëri-tjetrin kanë vjedhur banesat e personave Xh.Sh. dhe S.N., banues në Bathore, ku kanë vjedhur një televizor, një shumë lekësh, vegla bujqësore dhe ndërtimi.

**Policia kufitare e Qafë-Thanës: Në 10 muaj**

**janë goditur 41 raste të veprave penale**

QAFË-THANË - Policia Kufitare e Qafë-Thanës deklaroi dje të dhëna për punën në 10-mujorin e fundit. Sipas njoftimit saj, gjatë këtyre 10 muajve efektiviteti e Stacionit të Policisë Kufitare Qafë-Thanë kanë qenë të angazhuar në drejtim të parandalimit, evidentimit dhe goditjes së paligjshmërisë, kryesisht trafikimit të lëndëve narkotike, qenieve njerëzore, mjeteve motorike. Gjatë periudhës janar-tetor 2017, totali i hyrje-daljeve të shtetasve është 1 317 186 dhe 49 449 mjete. Ndërkohë, gjatë këtij 10-mujori janë evidentuar dhe goditur 41 raste të veprave penale, me 53 shtetas të proceduruar. Konkretisht janë proceduar 7 shtetas për kontrabandë me mallra që paguhet akcizë, 8 shtetas për falsifikim të vulave, stampave ose formularëve; 3 shtetas për kontrabandë me mallrat e tjerë; 1 shtetas për kanosje për shkak të detyrës dhe 32 shtetas për trafikim i narkotikëve, mbetur në tentativë.

Një 35-vjeçar nga Lezha përsërit tentativën e tij për vetëvrasje, duke i vënë zjarrin vetes para parlamentit. Saimir Zalli është i divorcuar nga gruaja, prindërit e së cilës nuk lejojnë të takojë fëmijët. Mësohet se shkak për këtë tentativë është bërë moszbatimi i vendimit të Gjykatës së Lezhës, e cila u ka dhënë kujdestarinë e fëmijëve. Ngjarja ndodhi në orët e paradites së



35-vjeçari nga Lezha

## Prindërit e ish-gruas nuk e lejojnë të takojë fëmijët

35-vjeçari nga Lezha i vë flakën vetes para parlamentit

djeshme. Një gardist ka parë 35-vjeçarin në flakë dhe ka ndërhyrë menjëherë, duke e shuar me ujë. Për shkak të dëgjies, 35-vjeçari ka marrë plagë në duar, ndërkohë që policia ka bërë transportimin e tij për në spitalin e dëgjies në Tiranë. Mësohet se Saimir Zalli është babai i

dy fëmijëve dhe është divorcuar nga bashkëshortja në vitin 2015. Më herët në datë 16 tetor, ai ka tentuar të hidhej nga lartësia e një vinçi në qendër të kryeqytetit. Ashtu si tri javë më parë, edhe dje Zalli pranon se është fakti që nuk e lënë të shohë dy vajzat e tij, shkak i ve-

primeve të ndërmarrja për vetë flajim. Më 19 tetor i riu lezhjan rrëfeu ekskluzivisht për emisionin "Me zemër të hapur" proceset e shumta gjyqësore dhe konfliktin që kishte me prindërit e ish-bashkëshortes, të mbetur invalide pas një aksidenti të pësuar kohë më parë.





Momenti i arrestimit

## I premtuan një qytetari se do e punësonin në FA, arrestohet ushtaraku dhe një tjetër

**VLORE** - Policia e Vlorës në bashkëpunim me Task Forcë të Prokurorisë Vlorë dhe Drejtorinë e Forcës së Posaçme në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, pas një hetimi me metoda speciale kanë arrestuar dy persona. Mësohet se gjatë operacionit të koduar

"Rekrutimi" u vunë në pranga 23-vjeçari Deraldo Kamberi 23 vjeç, me detyrë punonjësi i Policisë Ushtarake në Vlorë si dhe 23-vjeçari Erlind Varfi, të dy banues në Vlorë. Burime zyrtare nga policia e qytetit bregdetar dje bënë me dije se dy personat në fjalë u kapën

në flagrancë, pasi në bashkëpunim me njëri-tjetrin i kanë marr një shtetas, një shumë vlerash monetare prej 2000 euro me premtimin se do ta ndihmonin të punësohej në Strukturën e Forcave të Armatosura. Ndërkaq, blutë kanë sekuestruar në cilësinë e

provës materiale shumë e vlerave monetare prej 2000 euro. Materialet në ngarkim të efektivit të Policisë Ushtarake, Deraldo Kamberi dhe bashkëmoshatarit të tij, Erlin Varfi u referuan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Vlorë për veprën penale të "Korrupsionit pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike, kryer në bashkëpunim". Pritet që gjykata e këtij rrethi të vendosë masën e sigurisë ndaj tyre.

## DOSJA E 'UFO'-S/ Nga vrasja në Gjermani, tek dy arratisjet spektakolare nga burgjet e Italisë

# U arratis nga burgjet italiane, lirohet Ilir Paja

Vendimi nga gjyqtarja Enkeleda Hoxha, që la të lirë dhe Genc Tafilin

**KRUJË**

Gjykata e Krujës ka lënë të lirë një tjetër të dënuar. Bëhet fjalë për të "tmerrshmin" e Beratit, Ilir Paja, i cili është një personazh i njohur për arratisjet e tij spektakolare nga burgjet italiane. Mësohet se Paja është lënë i lirë me pretendimin se ai vuante nga një sërë sëmundjesh (kishte shfaqur probleme shëndetësore, që ishin vërtetuar edhe nga mjekët). Ai ishte dënuar me 16 vjet e 8 muaj heqje lirie dhe 2 milionë lekë gjobë për plagosjen e rëndë të efektivit të njësisë operacionale të policisë, Blendi Haxhimali. Ngjarje kjo e ndodhur më 6 mars të vitit 2008, në afërsi të farmacisë nr.10 në Tiranë. Vendimi për lirimin e Ilir Pajës është dhënë nga gjyqtarja Enkeleda Hoxha, e cila firmosi dhe lirimin për Genc Tafilin (vëllain e Admir Tafilit) i dënuar për vrasjen në bashkëpunim të kolonel Arben Zyllytarit.



Ilir Paja

**DOSJA E "UFO"-S**

Ilir Paja, i dënuari që u la lirë është një person i njohur për drejtësinë shqiptare, por edhe atë italiane. Ai ishte person në kërkim ndërkombëtar, sepse ndaj tij është dhënë dënimi për një vrasje të kryer në Gjermani. Ndonëse u arrestua në Itali, pas disa muajsh dënim, në qershor të vitit 2006, ai ka mundur të arratiset nga paraburgimi i Perugia-s, duke përdorur çarçafet si litar, deri në arrestimin e tij të dytë, më 4 shtator 2006. Shqiptari ishte burgosur prej 5 muajsh në pritje të ekstradimit nga Gjermania, ku akuzohej për vrasjen e një shqiptari tjetër në Duisburg. Paja u ndalua në Itali dhe ndaj tij u shtua edhe akuzat për shfrytëzim prostitucioni. Por, ai ka mundur të ikë sërish nga burgju, më 14 gusht të 2007-ën, ndërsa policia ishte duke e transportuar me ambulancë, për shkak se i dënuari ishte në gjendje

**VENDIMI**  
Vendimi për lirimin e të dënuarit Ilir Paja është dhënë në të njëjtën ditë dhe nga e njëjta gjyqtare që liroi dhe Genc Tafilin, vëllain e Admir Tafilit. Bëhet fjalë për gjyqtaren e Krujës, Enkeleda Hoxha. Pas lirimit të Genc Tafilit, që ishte dënuar për vrasjen e kolonel Arben Zyllytarit, reagoi prokuroria e Krujës, e cila deklaroi se vendimi është dhënë në kundërshtim të hapur me ligjin. Prokuroria, por edhe Presidenti i Republikës, Ilir Meta kërkan që KLD-ja të verifikonte rastin në fjalë.

**DËNIMI**  
Ilir Paja ishte dënuar me 16 vjet e 8 muaj heqje lirie dhe 2 milionë lekë gjobë për plagosjen e rëndë të efektivit të njësisë operacionale të policisë, Blendi Haxhimali. Ngjarje kjo e ndodhur më 6 mars të vitit 2008, në afërsi të farmacisë nr.10 në Tiranë. Para se të vihej në pranga, Paja ishte shpallur në kërkim për vrasje në Gjermani dhe për rrëmbim e përdhunim në Itali. Ai ishte pagëzuar nga italianët me nofkën "UFO" për shkak të arratisjeve spektakolare nga burgju.

shumë të rëndë psikologjike dhe kishte tentuar disa herë vetëvrasjen. Kësaj here kishte bërë si i sëmurë psikik dhe kur e kishte transportuar me ambulancë, kishte filluar të rënkonte e të tërhiqte vëmendjen e policit kryesor. Kur ky është afruar, Paja i ka dhënë një grusht në fytyrë. Më pas ka hapur derën e autoambulancës dhe është larguar me vrap, ku ka kapërcy-

er një mur të lartë dhe ka ndjekur linjën e trenit. Edhe pse policët kanë qëlluar në ajër, ai nuk ka ndaluar. Më pas është futur në një pyll dhe është zhdukur. Pas arratisjes së dytë në Itali, Ilir Pajës (u v nofka "UFO") është kthyer në Tiranë, ku jetonte i fshehur. Ai u arrestua nga blutë e kryeqytetit në mars të vitit 2008 për plagosjen e efektivit Blendi Haxhimali.

## Plagosi efektivin e policisë në mars të 2008-ës, ja si u arrestua i "tmerrshmi" nga Berati

**TIRANË** - Në një rindërtim të skenës së ngjarjes së ndodhur më 6 mars të vitit 2008, prokuroria pohoi atëherë se agjentët e sektorit të operacioneve speciale dhe kërkimit në policinë e Tiranës, Blendi Haxhimali dhe R.Mete kanë qenë me shërbim përballë maternitetit "Koço Gliozheni" në kryeqytet. Rastësisht agjenti Haxhimali ka vënë re personin që po lëvizte me makinën "Fiat Punto" me targa BC 983 DP, ngjyrë gri. Ky person ngjasonte me të kërkuarin Ilir Paja. Menjëherë agjenti ka lajmëruar eprorin e tij, D.Muça, ndërsa ky i fundit ka autorizuar ndjekjen e personit të dyshuar, pasi edhe ai bashkë me drejtues të sektorit të operacioneve speciale A.Caka po shkonin për në vendin ku ishte dhënë informacioni. Agjentët e policisë që po lëviznin me motorin e shërbimit "Skuter", kanë nisur ndjekjen e makinës së dyshuar në drejtim të kryqëzimit të zona e quajtur "Brryli". Agjentët në terren kanë qenë pa shenja dalluese policie, ndërsa janë përpjekur të mos binin në sy të personi i dyshuar. Makina me të cilën lëvizte Ilir Paja ka mbërritur të kryqëzimi pranë ish-farmacisë nr.10, por për shkak të trafikut është detyruar të qëndrojë në radhën e parë të kryqëzimit fare pranë policit që po drejtonte qarkullimin. Në këtë kohë, në korsinë në krah të majtë të personit të dyshuar, duke qenë se ajo ishte bosh, ka hyrë mjeri tip "Benz" ku ndodheshin eprorët e agjentëve të policisë që



kishin ndjekur me motor Ilir Pajën deri në atë moment. Pasi është siguruar se bëhej fjalë për Ilir Pajën, drejtuesi i makinës "Benz" i ka prerë rrugën diagonalisht automjetit të Ilir Pajës për të penguar largimin e tij përpara. Oficeri D. Muça ka zbritur nga makina dhe i është drejtuar Ilir Pajës me fjalët: "Policia, dorëzohu!". Në këtë kohë, pas makinës së Ilir Pajës, rreth 1.5 m larg saj, ndodhej agjenti i policisë B. Haxhimali me motorin e tij, ndërsa agjenti tjetër kishte zbritur dhe ishte afruar në këmbë për t'u shkuar në ndihmë kolegëve duke thirrur "Policia". Sapo ka parë policët që po i drejtoheshin atij, Ilir Paja ka reaguar duke lëvizur makinën indietro me shpejtësi. Ai ka marrë poshtë motorin e agjentit B.Haxhimali, ndërsa mjeti ka vazhduar lëvizjen duke kaluar trafikndarësen dhe duke mbajtur nën vete zvarrë, motorin dhe agjentin e policisë. Në këtë kohë, duke

parë se Ilir Paja i kishte drejtuar armën tip pistoletë, oficeri tjetër D. Muça ka qëlluar dy herë drejt makinës "Fiat", duke arritur të plagosë Ilir Pajën me një plumb. Makina e Ilir Pajës ka ndaluar vetëm pas përplasjes me autobusin e Unazës, që kishte ndaluar rastësisht aty. Agjenti i policisë, R.Mete, për të neutralizuar veprimet e Ilir Pajës ka qëlluar dy herë me armë të xhami i derës së djathtë në drejtim të kroskotit për të hapur derën e pasagjerit. Ai e ka hapur derën, ka bllokuar armën dhe ka nxjerrë jashtë Ilir Pajën, duke e shtrirë për tokë. Më pas ai ka shkuar të ndihmonte personat e tjerë që po përpqeshin të nxirrin nga poshtë makinës së Ilir Pajës, agjentin e policisë, B.Haxhimali. Ky i fundit pasi është nxjerrë në gjendje të rëndë nga poshtë makinës, është çuar në spital nga efektivat e policisë.

Kolegët e viktimës: Migena e shihte djalin me sytë e një nëne të dashuruar

# Vrasja makabre në Udine të Italisë, 30-vjeçarja po ndahej nga burri

Mediat italiane: Babai vrasës gënjeu djalin 8-vjeçar, i tha "mami ka shkuar disa ditë në Shqipëri"

ITALI

Një ditë pas vrasjes makabre të 30-vjeçares shqiptare, Migena Këllezi nga burri i saj Dritan Sulollari, mediat italiane ka zbardhur detaje të reja në lidhje me ngjarjen e rëndë të ndodhur në Udine. Sipas mediave të vendit fqinj, një krizë që po rrezikonte martesën e tyre duket të ketë qenë shkaku i krimi. "Il piccolo" shkruan se pavarësisht dëshmi të fqinjëve se kurrë nuk kishin dëgjuar grindje mes tyre, në çift ka pasur mosmarrëveshje. Por, nga hetimet e policisë rezultoi se martesë e tyre ishte në krizë, ndërsa thuhet se Dritan Sulollari po ndahej nga Migena Këllezi. Ndonëse jetonin ende në një shtëpi, praktikisht ata po ndaheshin. Po ashtu, në profilin e saj në "Facebook", gruaja nuk postonte më foto me bashkëshortin e saj, ndërsa aty kishte foto me kolegë, ndërsa protagonistin ishte djali i saj. Pas vrasjes, djali 8 vjeç i çiftit është strehuar tek një mik i familjes. Ndërsa gjyshërit që jetojnë në Shqipëri, mësohet se janë nisur drejt Italisë, sapo morën lajmin e rëndë të vrasjes së Migena Këllezit. "Unë po iki të mjekohem në spital, kurse mami ka ikur për disa ditë në Shqipëri". Kështu mësohet t'i ketë thënë Dritan Sulollari djalit të tij 8-vjeçar, pak pasi i kishte vrrarë nënën, Migena Këllezi. "Il gazzettino" shkruan se 37-vjeçari kishte gënjer të birin e mitur, që ky i fundit të mos shihte skenën makabre të asaj çka kishte ndodhur në banesën e tyre në "Gradisca d'Insonzo". Avokati pohoi se pavarësisht nga gjendjes së rëndë psikologjike dhe pasi iu nënshtrua operacionit në tendinën e dorës, Sulollari ka tentuar që djali të largohet sa më parë nga vendi i ngjarjes.

## KOLEGËT E VIKIMËS

"Ishte gjithmonë e qeshur. Nuk mund të japim asnjë shpjegim për tragjedinë". Kështu pohuan kolegët e Migena Këllezit, e cila u masakrua me thikë nga bashkëshorti i saj, Dritan Sulollari. Mësohet se Migena punonte në një dyqan telefonash në qendrën tregtare "Tiare Villesse". "Ajo ishte përshtatur shumë mirë me ambientin (kishte pak muaj që kishte nisur punë aty) dhe e kishte përvetësuar gjuhën italiane në mënyrë të përkryer, aq sa nuk dukej që ishte e huaj, edhe pse e donte jashtëzakonisht vendin e saj", thanë mes të tjerash kolegët e saj. "Il piccolo" shkruan se teksa kolegët u pyetën nëse kishin dijeni për marrëdhënien e Migenës me burrin e saj, ata thanë se nuk dinë asgjë. "Kishte shumë pak kohë në punë që të flisnim në intimitet", - u



Çifti Dritan Sulollari dhe Migena Këllezi

## NGACIMI SEKSUAL

Mediat italiane kanë zbuluar edhe një detaj të errët nga e kaluara e 37-vjeçarit Dritan Sulollari. Pavarësisht se ishte punonjës shumë i mirë, disa vjet më parë ai ishte larguar nga një piceri në Gorizia, pasi një kolege e kishte akuzuar për ngacim seksual.



## NGJARJA

Krimi i rëndë ndodhi mëngjesin e së mërkurës në Udine të Italisë. Dritan Sulollari, emigrant prej 20 vitesh në këtë vend masakroi me thika bashkëshorten 30-vjeçare, Migena Këllezi. Pas vrasjes për motive xhelozie, ai ka njoftuar policinë duke u thënë: "Hajdeni se kam vrrarë gruan time".

## Mbërriti në Itali me gomone, 37-vjeçari që vrau gruan: Skafistët i hidhnin njerëzit në det

ITALI - Rreth 20 vite më parë, Dritan Sulollari kishte mbërritur në Itali. "Detin natën, e ke parë ndonjëherë? Ai po që është i frikshëm". Niste kështu rrëfimi i Sulollarit për një mik për atë udhëtim nga Shqipëria në Itali. Ai zbriti në Puglia kur ishte 17 vjeç. Ishte viti 1998. Pas udhëtimit me një gomone me katër motorë me 100 kuaj-fuqi secili, ai nuk mundi të ulej për dhjetë ditë me radhë. Aventura e tij me skafistët kishte qenë dramatike. "Pjesa e përparme e gomones hidhej mbi errësirën e dallgëve dhe kur zbrishte poshtë përplasej në ujë dhe lëshonte xixa. Duket



absurde, por kështu ishte. Dhe të gëndonje aty ishte gjëja më e tmerrshme". Kishte

treguar që skafistët nuk kishin skrupuj dhe i hidhnin njerëzit në ujë për të le-

htësur gomonen dhe për t'ia mbathur kështu nga Guardia di Finanza. Sulollari kishte shkuar vetëm në Itali dhe pas një periudhe në ilegalitet, kishte arritur të merrte dokumentet dhe kishte gjetur një punë, shkruan "Il Piccolo". Punonte si kamerier në piceri. Pas një "pelegrinazhi" të gjatë, kishte ndaluar në Gradisca d'Isonzo. Dhe pikërisht aty i kishte ardhur dhe bashkëshortja, me të cilën ishte martuar 10 vite më parë. Më pas çifti ishte bërë me një djalë. Ata kishin të dy nënsh-tetësi italiane".

shprehën ata. Ndërsa pohuan se "ajo kurrë nuk fliste keq. Nuk ia kishim idenë më të vogël se mund të ndodhte kjo dramë. Migena ishte gjithmonë në dispozicion të djalit të saj. E shikonte me sytë e një nëne të dashuruar. Djali ishte mendimi i parë. Na fliste për djalin, tamam si mamatë tipike që

mbrojnë thesaret e tyre". **VRASËSI** Dritan Sulollari, 37-vjeçari shqiptar që vrau gruan e tij në Itali ishte një punonjës shumë i mirë për ish-pronarët. Mediat italiane në përpjekje për të zbardhur ngjarjen e rëndë kanë marrë dëshmi të shumta si nga miqtë, ashtu edhe

nga fqinjët dhe ish-punëdhënësit e tij. Sipas ish-punëdhënëseve të tij, nga pikëpamja profesionale, Dritan Sulollari ishte shumë i mirë. Ai kishte punuar kamerier në disa piceri. "Ai dinte se si të merrej me klientët dhe nuk i shpëtonte asgjë. I mjaftonte një shikim me bisht të syrit për

të pasur nën kontroll të gjithë situatën e sallës", thanë ata. Por, mediat kanë zbuluar edhe një detaj të errët nga e kaluara e tij. Pavarësisht se ishte punonjës shumë i mirë, disa vjet më parë ai ishte larguar nga një piceri në Gorizia, pasi një kolege e kishte akuzuar për ngacim seksual.

## SHKURT

### Treni përplaslet me makinë e policisë, plagosen 3 efektivë

**DURRËS** - Tre punonjës të policisë kanë mbetur të plagosur në Durrës, pasi mjeti me të cilin udhëtonin është përplasur me një tren mallrash. Ngjarja ka ndodhur dje rreth orës 02:40, në lagjen nr.13, sektori "Iiria". Sipas policisë, treni i skrapit i linjës Durrës-Elbasan, me mashinist shtetasin M.K., vjeç 61, banues në Durrës, është përplasur me mjetin e policisë. Si pasojë e aksidentit janë dëmtuar tre punonjës policie, dy prej të cilëve pas mjekimit të marrë në spital janë larguar për në banesë E.J. dhe S.D. Ndërsa i treti, Sh.P. ndodhet në spital jashtë rrezikut për jetën. Pas sinjalizimit për aksidentin, policia ka shkuar në vendngjarje dhe ka nisur hetimet.

### Përleshje në burg, plagosen me thika tre shqiptarë

**GREQI** - Një sherr me thika në burgun grek të Trikalas ka përfunduar me plagosjen e tre shqiptarëve. Mediat greke shkruajnë se shqiptarët kanë nxjerrë thikat dhe janë përleshur me njerëjtërin. Bëhet fjalë për të burgosurit e dy qelive të ndryshme të sektorit B.. Tre të burgosur, të gjithë shqiptarë janë plagosur me thikë. Njëri prej tyre (34-vjeçar) ndodhet në gjendje të rëndë, ndërsa dy të tjerët në gjendje të mirë shëndetësore. Paraprakisht dyshohet për larje hesapësh, shkruan 'zougla.gr'.

### Goditet grupi i kokainës në Athinë, e drejtojnë një shqiptar nga burgu

**GREQI** - Një grup kriminal i shpërndarjes së drogës është goditur në Greqi. Operacioni është zhvilluar në kryeqytetin grek, ku janë arrestuar 10 grekë dhe një shqiptar. Mediat lokale shkruajnë se grupi kriminal drejtohej nga një shqiptar 35-vjeçar i burgosur. I riu ishte arrestuar për trafik kokaine më 13 tetor 2017 në portin e Pireut. Sipas mediave greke, vitet e fundit ky grup ka fituar mbi 200.000 euro nga trafikimi i drogës. Gjatë operacionit janë sekuestruar 1 kg 615 gr kokainë, 750 gr përzierës, 59 mijë euro, 30.000 lek të reja shqiptare, dy kartëmonedha false 50 dhe 20 euro, 6 makina luksoze, 1 motor, 18 celularë, 3 libraze banke, 2 karta krediti etj.

**ZBARDHET SKEMA/** Shefi i policisë, Cevallos: Viktima, objekt i një hetimi

# Trafiku i kokainës, atentatit shqiptarit në Ekuador

*"Femra që e shoqëronte uli xhamin, atentatori qëllloi me armë"*

Një shtetas shqiptar mbeti i plagosur në Ekuador të Amerikës Latine. Dyshohet se ngjarja ka lidhje me trafikun e kokainës. Mediat vendëse nuk japin emra, por mësohet se shqiptari ishte i shoqëruar me një femër gjatë atentatit. Ata po udhëtonin me një makinë të blinduar në rrugët e Guayaquil-it, por gruaja që ishte me të uli xhamin për të pirë një cigare. Ngjarja ka ndodhur pasditen e 7 nëntorit 2017, në rrugët Tungurahua dhe Primero de Mayo, në qendër të qytetit Guayaquil. Atentati u njoftua të mërkurën nga Germán Cevallos, kreu i Zyrës Kombëtare për krime kundër jetës, vdekjet e dhunshme, zhdukje, grabitje dhe rrëmbim (Dinased) në zonën 8. Ngjarja ndodhi pak pas orës 17:00 duke alarmuar banorët e zonës. Mediat vendëse kanë zbardhur skemën e ngjarjes dhe kanë publikuar dëshmi të personave të pranishëm në vendngjarje. Në artikujt e publikuar mbi ngjarjen, thuhet se shqiptari ishte i shoqëruar me një femër gjatë atentatit. Ata po udhëtonin me një makinë të blinduar në rrugët e Guayaquil-it, por gruaja që ishte me të uli xhamin për të pirë një cigare. Atentatori, i cili me sa duket në ndjekje të shqiptarit, ka shfrytëzuar këtë moment për të qëlluar mbi objektin. Ai futi armën përmes dritares dhe qëlloi disa herë mbi shqiptarin. Bëhet e ditur se ai jetonte në Ekuador prej 8 vjetësh.

## REAGIMET

Shefi i policisë së qytetit, Germán Cevallos tha se ngjarja dyshohet të ketë ndodhur për shkak të prishjes së pazareve të drogës. "Një femër që udhëtonte me viktimën uli xhamin e mjetit të blinduar për të pirë një cigare. Në atë kohë një person i cili e kishte ndjekur viktimën me një motor, futi armën përmes dritares dhe qëlloi disa herë mbi viktimën", tha Cevallos. Sipas mediave vendëse, bëhet fjalë për një prishje pazari prej miliona dollarësh në trafikun e kokainës.

Tregtarë të zonës shprehën të shqetësuar pas ngjarjes, pasi frika për sigurinë në qytet është rritur. Një prej tyre thotë se ka parë persona të armatosur në zonë. Ndërsa një tjetër thotë se i armatosuri mund të kishte rrezikuar edhe jetën e personave të tjerë. Mësohet se mjeti me të cilin lëvizte objektivi i atentatit ishte i blinduar. Shqiptari



## SHEFI I POLICISË CEVALLOS

"Një femër që udhëtonte me viktimën uli xhamin e mjetit të blinduar për të pirë një cigare. Në atë kohë një person, i cili e kishte ndjekur viktimën me një motor, futi armën përmes dritares dhe qëlloi disa herë mbi viktimën", tha Cevallos. Gazetari Artan Hoxha ka reaguar pas ngjarjes në Ekuador duke treguar disa detaje.



**Dijet furgoni në Korçë, pronari: E qëllimshme, para një muaji ma vodhën**

**KORÇË** - Një automjet është djegur duke u zbardhur e enjtja në Korçë. Ngjarja ka ndodhur në orët e para të mëngjesit, në lagjen nr.4 të qytetit. Mësohet se mjeti tip furgon ka qenë i parkuar para banesës së pronarit, Leonit Prethi. Ky i fundit u shpreh për "BalkanEëb" se mjeti përdorej nga dhëndri i tij. Nga të dhënat paraprake dyshohet se zjarri mund të ketë qenë i qëllimshëm. "Furgonin e nget dhëndri im. Me atë mban familjen. Është hera e dytë që ndodh, pasi para një muaji ma vodhën, tani ma doqjen. Dyshoj që ka qenë zjarr i qëllimshme. Ekspertët na thanë që mund t'i jetë hedhur naftë për ta djegur. Nuk e dimë pse, presim që policia ta zbardhë ngjarjen", pohoi Leonit Prethi për gazetaren Iris Rezhdha. Ndërkohë, policia po vijon hetimet për zbardhjen e plotë të ngjarjes.

## Gazetari zbulon detaje, atentati i dytë ndaj një shqiptari

**Artan Hoxha: Si vjen droga në Shqipëri për t'u shitur në tregun evropian**

I ftuar në emisionin "Të paeksponuarit" nga Ylli Rakipi, në televizionin "News 24", gazetari Artan Hoxha ka treguar disa detaje në lidhje me atentatin e bërë ndaj shqiptarit ditën e sotme në Ekuador. Sipas tij, ngjarja e fundit ka ndodhur në maj të këtij viti, ku humbi jetën një tjetër shqiptar. Ai tha se atentatet janë bërë në mënyrë identike. "Edhe ngjarja e parë ka qenë në ditë të martë, ka qenë nga mbrapa, me motor. Këto ngjarje kanë të gjitha detajet njësoj, kanë lidhje me njëra-tjetër. Është pohuar edhe nga policia në Ekuador, por gjatë kohës kanë ndodhur dhe katër vrasje të tjera të lidhura", tha ndër të tjera Artan Hoxha. "Kur ndodhi ngjarja e 30 majit në po këtë qytet, u qëllua një shqiptar që u het Ilir Hidri, 30 vjeç. Ai kishte shkuar për një sasi kokainë, me vlerë 15-20 mln dollarë, nëse shkente në tregun evropian. Edhe atij iu bë atentat mafioz. Dy persona me motor e qëlluan nga pas koke. Drejtori i policisë së krimit të organizuar në vend ka reaguar



Gazetari Artan Hoxha

pas ngjarjes së dy ditëve më parë dhe thotë se ngjarjen lidhen me njëra-tjetër. Ai thotë se ekzekutori mund të jetë autor edhe i 4 vrasjeve të tjera në vend. Teksa po udhëtonte bashkë me një femër në makinë, më 7 nëntor iu bë atentat një shqiptari tjetër. Ai lëvizte me makinë të blinduar, por gruaja uli xhamin e makinës për të pirë cigare dhe në atë moment, ekzekutori ka qëlluar me armë drejt objektivit", rrëfë ai ngjarjen. Sipas tij, "fakti që shqiptarët kanë vajtur dhe janë bërë faktor atje,

kanë shkuar në burim. Pra, kanë shkuar të mbyllin ciklin. Të njëjtën gjë bëjnë me kanabisin nga Pakistani". Hoxha foli për një skemë të qartë trafiku nga Ekuadori dhe tregoi se si mafia shqiptare me agresivitetin e saj në treg po arrin të ketë sukses. Ai tha se shqiptarët e marrin drogën në origjinë dhe e sjellin në Shqipëri për ta rihedhur sërish në tregun evropian, e kështu fitojnë shumë marramendëse parash, një pjesë e mirë e të cilave investohet në Shqipëri. "Grupet shqiptare po ndeshen me njëri-tjetrin në burim. Në qershor 2014 u kap një kolumbian, u kap laborator kokaine në periferi të Tiranës. Droga erdhi nga Ekuadori dhe do shkonte në Fier, konteneri me drogë në Mal të Zi. Do shkonte droga në një kompani në Fier në pronësi të një gruaje në moshë", tha Hoxha. "E sjellin në Shqipëri dhe më pas e çojnë në Perëndim. Vjen droga këtu, përpunohet se vjen këtu e papërpunuar. Në një rast e kishin tretur në rroba dhe me anë të kimikateve në laboratorike e sjellin në gjendje e mëparshme dhe më pas e përpunojnë dhe e shesin në Perëndim", tregoi gazetari.

kishte marrë edhe shtetësinë e Ekuadorit dhe ka jetuar në vend për tetë vjet. "Objektivi i atentatit udhëtonte me një mjet të blinduar, çka tregon se ai ndihet i kërcënuar. Viktima ishte

gjithashtu objekt i një hetimi që po bëjmë për një ngjarje që ndodhi më 30 maj me një shtetas të huaj", tha Cevallos. Sakaq, policia ekuadoriane është vënë në ndjekje të autorëve të aten-

tatit të ndodhur dy ditë më parë ndaj shqiptarit. Mjeti në të cilin lëvizte viktimja ishte i blinduar. I plagosuri u transferua në një klinike shëndetësore dhe pasi iu dha ndihma e parë, thuhet

se është në gjendje të gëndrueshme. Atë ditë, një person tjetër me origjinë shqiptare (Ilir Hidri) u vra duke ecur në Rrugën 36 dhe Ch, në periferi të Guayaquil, nga dy individë që e qëlluan

an atë nga një motor. Në një incident tjetër, policia njoftoi kapjen e Xavier S., 22 vjeç, i cili akuzohet si përgjegjës për tri vrasje. Dy prej tyre ndodhën në shtator 2017, në familinë urbane Pascuales. Krimi tjetër ndodhi në gusht, në një diskotekë në veri të qytetit. S. Xavier do të ketë lidhje me vjedhjen e një automjeti të blinduar me vlerë të madhe monetare për llogaritë të një kompanie transporti, parkuar jashtë një dyqani në Citadel Los Alamos, në veri të qytetit më 28 shtator 2017. Gjurmët e gishtave të jetura në automjet do t'i përkisnin të paraburgosurit, i cili regjistroi të dhënat penale për trafikimin e substancave narkotike.

Ekspertët: Lexoni rregullat me kujdes, ligji zbatohet njësoj për të gjithë

Voltiza Duro

# Lotaria Amerikane, ambasada: Kriteret për një aplikim të suksesshëm

## "Si duhet të veproni gjatë regjistrimit"

Ambasada amerikane ka theksuar edhe njëherë kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për të aplikuar në mënyrë të suksesshme në programin e lotarisë DV-2019. Në mënyrë që të kenë mundësi për t'u përzgjedhur, të gjithë ata që duan të jetojnë e të punojnë në Shtetet e Bashkuara, duhet të kenë kujdes e të aplikojnë vetëm një herë, në të kundërt skualifikohen. Ambasada, gjithashtu, njofton se kandidatët duhet të përfshijnë në aplikim të gjithë anëtarët e kualifikueshëm të familjes e duhet të kenë kujdes që të ngarkojnë foton e saktë për secilin prej tyre. Sipas njoftimit zyrtar, të interesuarit duhet të heqin syzet për foton, e cila duhet të jetë e re për çdo vit aplikimi. Këtë vit, regjistrimet për Lotarinë Amerikane, pas problemeve teknike, rinisën nga e para në 18 tetor e do të vijojnë deri në 22 nëntor 2017. Ky njoftim mbi kriteret që duhen plotësuar nga aplikantët, vjen pas deklaratës së kreut të Shtëpisë së Bardhë, Donald Trump, i cili kërkoi mbylljen e këtij programi. Por, në një intervistë të dhënë disa ditë më parë për "Gazeta Shqiptare", avokati i Emigracionit, Kieran Both qartësoi të interesuarit që duan të jetojnë në "tokën e premtuar", se presidenti Trump mund të thotë shumë gjëra, por në Amerikë është ligji që vendos. Both e shikon si të pamundur mbylljen e programit të Lotarisë. Në faqen zyrtare të ambasadës, në rrjetin social "Facebook", ekspertët sqarojnë se përgjigjet për fituesit do të shpallen prej 1 majit të 2018-ës. "Ju duhet ta kontrolloni statusin tuaj nga 1 maji 2018 deri më 30 shtator 2019. Kontrolli i Statusit të të regjistruarit do të jetë e vetmja mënyrë informimi mbi përzgjedhjen tuaj për Lotarinë DV-2019, duke ju dhënë udhëzime se si të vazhdoni më tej me aplikimin tuaj dhe duke ju njoftuar mbi takimin për vizë emigrimi", thekson ambasada. Ndërkaq, kjo e fundit nënvizon se të ardhurat e sponsorit që del garant për të përzgjedhurit, duhet të jenë mbi 100 për qind të nivelit të varfërisë, që vendoset çdo vit nga Departamenti Amerikan i Shërbimeve të Shëndetit dhe Njeriut, në të kundërt kandidati duhet të gjejë një sponsor tjetër.

**KRITERET**  
Aplikanti duhet të ketë arsimin ose përvojën e punës si një ndër kriteret kryesore për të fituar. Gjithashtu, gjatë regjistrimit duhen përfshirë patjetër bashkëshorti/ja dhe çdo fëmijë nën moshën 21 vjeç e të pamartuar. Ndërsa të gjithë stu-



Ambasada amerikane në Tiranë

**KRITERET PËR NJË APLIKIM TË SUKSESSHËM:**

- Aplikoni vetëm një herë gjatë DV-2019
- Përfshini në aplikim të gjithë anëtarët e kualifikueshëm të familjes
- Hiqini syzet për foton
- Ngarkoni një foto të re për çdo vit aplikimi
- Ngarkoni foton e saktë për secilin anëtar të familjes

dentët që ende po ndjekin studimet në formularin e aplikimit nuk duhet të

përzgjedhin "University degree", por opsionin "Some university courses" pasi nuk janë diplomuar.

**PËRZGJEDHJA RASTËSORE**  
Çdo aplikuesi i vendoset një numër dhe kompjuteri në Qendrën Konsullore Kentucky përzgjedh numrat, pa asnjë dallim. Më pas shikohen aplikimet që kanë kryer regjistrim me shumë se një herë dhe skualifikohen. Pasi personi rezultoi i përzgjedhur dhe i caktohet data e intervistës, është oficeri konsullor që shqyrton çështjen e tij/saj dhe merr vendimin final për vizën, bazuar në kualifikimin dhe pranueshmërinë për vizë të aplikantit. "Ne ecim në bazë të rregullave dhe ligjeve që i gjeni në faqen tonë të internetit. Ne nuk refuzojmë askënd. Ne jemi shumë transparentë në punën tonë; ne bëjmë fushatë të gjerë sensibilizuese mbi kriteret e kualifikimit dhe gjithmonë kemi rekomanduar që të lexohen rregullat e kualifikimit përpara se të aplikojnë për lotarinë. Shpesh ndodh që nuk lexohen rregullat, nuk na kontaktojnë paraprakisht, dhe në sportel kemi në person me arsimin që nuk e kualifikon, apo bën gabime në aplikim - për të cilin jemi të detyruar të zbatojmë ligjin", sqaron ambasada amerikane.

### RASH do të ofrojë shërbime cilësore në universitete

## Marrëveshja Shqipëri-Itali: Qendër telematike për kërkimin shkencor

Në vendin tonë do të çelë qendër telematike kërkimi shkencor me një teknologji moderne, pas marrëveshjes mes qeverisë shqiptare e asaj italiane. Ministria e Arsimit, Sportit e Rinisë, Lindita Nikolla me 12 rektorët e universiteteve në të gjithë vendin, firmosën marrëveshjen për krijimin e Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar. Në vijim do të ndërtohet një qendër e përbashkët e kërkim-zhvillimit në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, pjesë e së cilës janë të gjitha universitetet publike dhe Ministria përgjegjëse për Arsimin dhe kërkimin shkencor.

Në vijim do të ndërtohet një qendër e përbashkët e kërkim-zhvillimit në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, pjesë e së cilës janë të gjitha universitetet publike dhe Ministria përgjegjëse për Arsimin dhe kërkimin shkencor. Kjo qendër do t'u mundësojë universiteteve shqiptare një shërbim të unifikuar cilësor dhe të sigurt të aplikacioneve software brenda rrjetit telematik dhe do të bëjë të mundur, që në këtë shërbim të kenë akses: pedagogë e studentë, mësues e maturante, si dhe gjithë agjencitë për arsimin dhe

mi i infrastrukturës për ngritjen e një qendre të përbashkët ndërdisciplinore kërkim-zhvillimi dhe shërbimesh TIK nga universitetet pjesëmarrëse. Gjithashtu, RASH synon zhvillimin e programeve software "in house", pjesëmarrjen dhe koordinimin e kërkuesve vendas në projektin europian të kërkimit "GEANT 2020" në fushën e teknologjisë së informacionit si dhe promovimin e mobilitetit të studentëve përmes shkëmbimit të dhënave elektronike të tyre. Kjo marrëveshje me Italisë e vendit



tonë erdhi në mbështetje të ligjit "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Italisë për realizimin e një qendre shërbimesh dhe të një rrjeti telematik për universitetet".

**TAKIMI**



Erion Veliaj me Michele Emiliano

## Menaxhimi i ujit të pijshëm, bashkëpunim me Pulian

Bashkia e Tiranës ka lidhur një tjetër bashkëpunim për menaxhimin e ujit të pijshëm me Rajonin e Pulias në Itali. Kryebashkiaku Erion Veliaj, priti në një takim presidentin e këtij rajoni, Michele Emiliano, me të cilin bisedoi mbi përfitimet e përbashkëta nga projektet e programit INTERREG, Pulia - Shqipëri, si dhe në çështjen e ujit të pijshëm. Veliaj theksoi se një projekt i tillë i jep fund shqetësimit të qytetarëve për

furnizimin me ujë të pijshëm. "Lajmi i parë i mirë ka të bëjë me miratimin e projekteve INTERREG, për bashkëpunim midis Ujësjellësit të Pulias dhe Ujësjellësit të Tiranës", tha kryetari i Bashkisë së Tiranës. Ndërkohë, rajoni i Pulias do t'i bashkohet nisjes së Bashkisë së Tiranës në projektin për krijimin e "Pylit Orbital", që do të rrethojë kryeqytetin me një brez me 2 milionë pemë.

Pedagogu i UT-së: Skema e regjistrimit penalizoi maturantët, të merren masa

Voltiza Duro

# Raporti i KLSH: Ministria e Arsimit ka shkelur ligjin

Jani Marka: Nuk është zbatuar meritë-preferenca

Sipas raportit të publikuar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, Ministria e Arsimit ka shkelur Ligjin për Arsimin e Lartë gjatë pranimeve në universitete të maturës shtetërore 2016. Pas verifikimeve të kryera, KLSH-ja ka arritur në përfundimin se procesi i regjistrimeve është realizuar duke shpërdoruar në mënyrë flagrante kohën dhe burimet njerëzore, si dhe duke shpenzuar në mënyrë të panevojshme fondet. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", Jani Marka, pedagog i Universitetit të Tiranës e njëkohsisht aktivist i lëvizjes "Për Universitetin" tregon se Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, edhe pse e ka marrë zyrtarisht raportin, nuk i ka pranuar konstatimet e KLSH-së dhe nuk është përpjekur të ndryshojë thelbin e skemës së regjistrimit. Gjithashtu, Marka thotë se problemet e evidentuara kanë rezultuar me deformimin e meritë-preferencës për një numër të konsiderueshëm maturantësh e kjo ka ndodhur edhe me maturën shtetërore të 2017-ës. Ndërkaq, në raportin e KLSH-së citohet se: "Modeli i pranimit që u aplikua në vitin 2016 dhe po përpigjet të implementohet sërish, nuk është ai i duhuri, si në konceptim, ashtu edhe në aplikim. Ky model nuk është në përputhje me frymën e Ligjit 80/2015 dhe as me praktikën e mira të vendeve perëndimore prej nga ky ligj është përshtatur". Në lidhje me këtë, pedagogu i UT-së thotë se për këto shkelje e padrejtësi nga ana e MASR duhet të merren masa, por ai shpreh skeptik nëse dikush do të vihet para ligjit për të dhënë llogari brenda një periudhe afatshkurtes.

**Si e vlerësoni ju raportin e publikuar nga KLSH-ja mbi maturën shtetërore 2016?**

Raporti i Kontrollit të Lartë të Shtetit ka theksuar, me argumentim profesional, të njëjtat problematika të evidentuara e kundërshtuar edhe nga vetë maturantët dhe jo vetëm në vjeshtën e shkuar. Në këtë kuptim, në njërin anë, ne e vlerësojmë pozitivisht raportin, por në anën tjetër, keqardhja është se Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, edhe pse e ka marrë zyrtarisht raportin, nuk i ka pranuar konstatimet e KLSH-së dhe për pasojë nuk është përpjekur të ndryshojë thelbin e skemës së regjistrimit.

**Cili ishte problemi kryesor që u konstatua nga ana juaj mbi pranimit në universitete për 2016-ën?**

Lëvizja "Për Universitetin" ka realizuar një studim, mbështetur në njërin anë në shqyrtimin kritik të udhëzimeve të shumta të nxjerra nga MASR dhe në anën tjetër, me të dhëna direkte të marra nga një pyetësor me rreth 400 ish-maturantë. Sh-



Jani Marka, pedagog i Universitetit të Tiranës, aktivist i lëvizjes "Për Universitetin"

## STUDENTET

"Të gjithë ata studentë, në raundin e dytë, të cilët nuk e kanë fituar preferencën e tyre të parë, por një preferencë tjetër, kanë qenë përballë një dileme, frike të vazhdueshme: të regjistrohen (duke humbur më tej të drejtën e garës), apo të vazhdojnë garën me rrezikun se mund të mbeten edhe pa shkollë në rastin më të keq të mundshëm. Kjo nuk është e pamundur të kuptohet nëse shqyrtohen me kujdes rezultatet e ish-maturantëve", - tha pedagogu.

kurtimisht, theksojmë se procesi kishte problematika shumë serioze, nga mënyra e vendosjes së kritereve nga universitetet, të cilat u shpallën me vonesë, pra vetëm disa muaj përpara përfundimit të maturës. Probleme janë evidentuar edhe në konceptimin teknik të procesit, përmes disa udhëzimeve nga ana e MAS.

## Çfarë reflektuan këto probleme të maturantët?

Të gjitha këto kanë rezultuar me deformimin e meritë-preferencës për një numër të konsiderueshëm maturantësh. Theksoj këtu faktin se studentët me rezultate të larta kanë humbur mundësinë e regjistrimit në degë të preferuara, të cilat prej vetë skemës dhe kaosit, janë përfituar nga studentët me rezultate më të ulëta. Vetë universitetet publike për shkak të skemës së aplikuar nuk realizuan kuota të parashikuara. Vlen të përmend se në degën e kërkuar të Farmacisë mbeten rreth 15 vende bosh.

## Si vijoi procesi i maturës shtetërore për 2017?

Lëvizja "Për Universitetin", për të nxjerrë në pah problematikën, aktualisht është duke kryer një studim duke pyetur studentët e viteve të para. Megjithatë, edhe pse studimi është ende në proces, mund të pohojmë se, nisur nga fakti që thelbi i skemës së regjistrimit është i njëjtë me vitin e shkuar, edhe këtë vit është cenuar meritë-preferenca.

**A ka pasur përmirësime krahasuar me një vit më parë?**

## REAGIMI NDAJ MASR

"Në njërin anë, ne e vlerësojmë pozitivisht raportin, por në anën tjetër, keqardhja është se Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë edhe pse e ka marrë zyrtarisht raportin, nuk i ka pranuar konstatimet e KLSH-së dhe për pasojë nuk është përpjekur të ndryshojë thelbin e skemës së regjistrimit. Procesi kishte problematika shumë serioze nga mënyra e vendosjes së kritereve nga universitetet", - u shpreh Marka.

në fund ballafaqimin e këtyre të dhënave. Natyrisht, MASR e ka shumë të kollajta ta kryejë një studim të tillë, meqenëse ka kompetencën të zotërojë tërësisht këto të dhëna. E megjithatë, besojmë se edhe studimi që ne po kryejmë, do të hedhë mjaftueshëm dritë.

## Çfarë sistemi regjistrimesh duhet të aplikohet në universitete?

Për shumë arsye, sidomos për shkak të zhvillimit të pabarabartë të sistemit shkollor parauniversitar në Shqipëri dhe të kuotave të kufizuara në degë të preferuara në universitetet publike, kjo mbetet një pyetje shumë e vështirë. Në këtë kuptim, një studim serioz e gjithëpërfshirës, sidomos përfshirja e vetë maturantëve, por edhe ekspertë të drejtës, do mund të jepte një përgjigje të drejtë për këtë çështje.

## A mendoni se do të merren masa mbi shkeljet që janë bërë nga MASR gjatë maturës shtetërore?

Për sa kohë ka shkelje e padrejtësi në dëm të interesit publik, kudo që të ndodhin ato, patjetër që duhet të merren masa. E megjithatë, në një kohë afatshkurtes nuk kam shpresë se dikush do të përgjigjet përpara ligjit për këtë çështje.

## A është rritur "artificialisht" emergjenca mbi procesin e regjistrimit, çka i detyroi maturantët të regjistroheshin në degë jo fort të pëlqyera?

Emergjenca, apo kaosi ishte një faktor kyç në procesin e vitit të shkuar, ndërkohë që këtë vit kjo u rregullua edhe prej presionit të maturantëve. Ndërsa këtë vit u shfaq e spekulua mjaft, çështja e akreditimit të universiteteve publike.

## Sipas raportit të KLSH-së ka pasur shpenzime të panevojshme financiare gjatë procesit të pranimit në IAL të maturantëve për vitin akademik 2016-2017. Cili është mendimi juaj lidhur me këtë?

Jo vetëm për këtë raport, por për çdo raport ku ngrihen dyshime për dëm ekonomik në kurriz të financave publike, apo në dëm të interesit publik (në raportin e KLSH evidentohet dëm edhe në kurriz të familjeve të varfra), supozohet që organet e drejtësisë të vihen automatikisht në lëvizje. Më tej, janë organet gjyqësore që duhet të thonë fjalën e fundit.



Raporti i publikuar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit mbi maturën shtetërore 2016

## gjatë procesit të regjistrimit në universitete?

Patjetër që janë "penalizuar". Të gjithë ata studentë, në raundin e dytë, të cilët nuk e kanë fituar preferencën e tyre të parë, por një preferencë tjetër, kanë qenë përballë një dileme, frike të vazhdueshme: të regjistrohen (duke humbur më tej të drejtën e garës), apo të vazhdojnë garën me rrezikun se mund të mbeten edhe pa shkollë në rastin më të keq të mundshëm. Kjo nuk është e pamundur të kuptohet nëse shqyrtohen me kujdes rezultatet (merita) e ish-maturantëve, renditjen e preferencave të tyre, të drejtën e studimit që kanë fituar dhe

**A u penalizuan studentët**

Përfitueset e para janë ish-të dënuarat politike gra, të cilat jetojnë në momentin e dhënies së pagesës

# Ish-të dënuarit, kësti i 8 brenda vitit, fondi 352 milionë lekë

*Ndryshimi në buxhet, marrin dëmshpërblimin 1500 ish-të përndjekur*

Ornela Manjani

Ish-të dënuarit politikë që janë gjallë do të përfundojnë këstin e tetë dhe të fundit të dëmshpërblimit. Pagesat do të kryhen brenda këtij vitit. Fondi i vënë në dispozicion është 352 milionë lekë. "Gazeta Shqiptare" ka siguruar listën e përfituesve në të gjithë vendin. Fondi për pagesën e fundit të dëmshpërblimit është vendosur në aktin normativ që ndryshon buxhetin e vitit 2017, i cili është dorëzuar dje në Kuvend. "Qeveria ka rritur me 352 milionë lekë fondin për kompen-

simin e ish-të përndjekurve politikë. Qëllimi është që të shlyhet 100% kësti i tetë dhe i fundit i kategorisë parësore të përfituesve të gjallë, deri në fund të vitit 2017". - thuhet në relacionin e aktit normativ.

## PËRFITUESIT

Lista është hartuar në bazë të klasifikimit të kategorive prioritare, të përcaktuara më parë nga dikasteri i Financave. Janë përcaktuar gjashtë kategori prioritare dhe dokumentet që duhen plotësuar për çdo kategori përfituese. Të parat në listë

janë gratë ish-të dënuara, që jetojnë në momentin e pagesës. Sipas urdhrorit të Ministrisë së Financave, në kategorinë e dytë me prioritet janë persona ish-të dënuar mbi 75 vjeç në datën e hyrjes në fuqi të ligjit, të cilët janë gjallë. Ndërsa, në kategorinë e tretë, me prioritet janë persona ish-të dënuar politikë të gjallë, që vuajnë nga sëmundjet të rënda. Për kategorinë e katërt prioritet kanë për persona ish-të dënuar që janë gjallë, të cilët pavarësisht pagesës, në momentin e moshës

Jo, nuk më vjen fare keq, sepse unë i kam provuar të gjitha detyrat: kryetar, nënkryetar, dekan, drejtor, matematicien, profesor në universitet, anëtar i Akademisë së Shkencave të Europës. Kam bërë shumë detyra në jetën time dhe di pse nuk më vjen keq? Sepse në fund të fundit do të diçka pas dhe të kam marrë ndërkohë shumë urime nga akademikë e profesorë. Po bëj diçka që kam lënë gjurmë, kam bërë gjithçka me shpirt. Kam 45 vjet në Akademi, është e gjithë jeta ime. Meqë mu argumentua që ka një shans për mirë duke hapur unë rrugë, do bëhet më mirë Akademia, hoqa dorë, sepse unë këtë dua. Unë prapë anëtar i Akademisë jam. Dhe nëse dua, kur të bëhen zgjedhjet, unë kandidoj prapë.

**- Do e bëni, do kandidoni sërish?**

Atë nuk e di. Nëse e kërkojnë akademikët, po. Unë do të mblledh

asambleen për ta falënderuar dhe për t'ua komunikuar, sepse nuk mundem ta kaloj në heshtje, sepse janë burra të nderuar. Presidenti më vlerësoi në komunikatën që nxori, por përpara atyre kolegëve që janë 10 herë më të mirë se unë, një pjesë e mirë e tyre, duhet t'i respektoj.

**- Profesor, ky debat, u hap nga akademiku Artan Fuga. Çështja shkoi deri tek kryeministri i vendit që kërcënoi me prerje fondesh, çka nënkupton shkrirje të Akademisë. Në një moment, profesor Fuga iu bashkua akademisë dhe akademikëve dhe u pa përkrah tyre në një konferencë për mediat. Ju si do i kemi marrëdhëniet me të?**

Jemi larg njëri-tjetrit. Edhe si punë që ka bërë njëri apo tjetri po ashtu. Unë kam punuar gjithë jetën e kam produkt në jetën time. Duke filluar që nga momenti që kam filluar punë si matematicien që kam punuar për sektorin e gjeologjisë, gjeofizikës dhe naftës, ku mbi bazën e atyre që kam bërë unë janë dhënë çmime, janë hap miniera e puse e në vazhdim, kur kam punuar drejtor i Institutit të Informatikës kam bërë të ngrihet një institut jo vetëm shumë të mirë që nuk kishte si ai në Ballkan dhe bëra atë që nuk e ka bërë njeri në në institut shkencor: veç projekteve shkencore, unë bëra një projekt ku futa në punë 1200 vajza për 10 vite rresht. Në vazhdim, kur erdha në Akademi e rindërtova atë në të gjitha pikëpamjet, pavarësisht asaj që thotë Artani e të tjerë që janë të gjitha gënjeshtra. Kur erdha unë, Akademia ishte në gjendje të mjeruar edhe ambientale. Kam 51 vjet që kontribuoj për peshëngritjen, ku ngrihet flamuri, ku këndohet himni, që nuk e bën askush tjetër. Jo më larg se para 1 viti, presidenti i Federatës Botërore erdhi dhe më dha një medalje vlerësimi. Ndërsa, ky që pyesni ky, nuk ka asnjë produkt, ka vetëm shkarravina. Nëse nuk e pëlqen Akademinë, le ta dorëzonte 50 mijë lekëshin që merr çdo muaj. E dini shkrimin më të mirë të tij? Atë që një gëshenjashitës, nuk i ishte më gëshenjës me kaus, por më kandar. Ai ka bërë vetëm shkarravina e ka sharë. Kur ka bërë ai diçka të mirë e produktive për të mirën e këtij kombi? Nuk krahasohet me mua. Ai s'ka ardhur asnjëherë në mblledhje. I thosha eja në mblledhje e na e thuj çfarë ke. Tani, kur erdhi puna që do të pritej fondi, dhe me prerjen e fondit ikën dhe 50 mijë lekësh, erdhi ai.

TRASHEGIMIA

**C**ështja e ndërtimit të një pike shërbimi në parkun arkeologjik të Butrintit, pasuri botërore e njerëzimit, është rikthyer në qendër të vëmendjes. Pas republikës mes kryetares së Komisionit të Medias, deputetes Albana Vokshi dhe ministres së Kulturës Mirela Kumbaro, ndërsa diskutohet buxheti i vitit 2018, dhe në parlament, ministria është thirrur në interpelancë nga një deputet i majtë. Ka qenë deputeti i PS, Alket Hyseni, i cili i ka kërkuar sërish llogari ministres e Kulturës Mirela Kumbaro për ndërtimin në parkun e Butrintit ditën e enjte. Deputeti Hyseni kërkoi sqarime për ndërtimin në Butrint, projektin dhe konsultimet, duke e vënë theksin te fakti se duhet një plan i qartë menaxhimi për parkun arkeologjik. Ai vuri në dukje se ka rezerva edhe për objektin edhe për elemente korruptive.

"Kur janë bërë konsultimet dhe cilat janë garancitë? Ka rezerva për menaxhimin e parkut të Butrintit pasi zbarkimet e turistëve të huaj janë katërfishuar, ndërsa të ardhurat janë dyfishuar. Mendoj se ka rezerva edhe për aspektin e elementeve korruptiv", u shpreh Hyseni.

**MINISTRJA**

Nga ana e saj, ministria Mirela Kumbaro, ribëri me dije se nuk është i detyrueshëm konsultimi për ndërhyrje të vogla, por vetëm kur bëhet fjalë për ndërhyrje të mëdha. Me subjektin që bën ndërhyrje kemi pasur konsultim dy vjet rresht dhe i ka pranuar të gjitha kushtet tona. Dua të sqaroj që zhvillimi i çfarëdo lloji projekti të ri, bëhet brenda një plani menaxhimi. Parku i Butrintit nuk është vetëm

# Butrinti "shkon" në parlament, Kumbaro debat me deputetët



mjaftueshme prandaj është i nevojshëm partneriteti publik-privat në investimet që po bëhen. "Nuk është i detyrueshëm konsultimi me UNESCO-n për ndërhyrje të vogla, por vetëm kur bëhet fjalë për ndërhyrje të mëdha. Me subjektin që bën ndërhyrje kemi pasur konsultim dy vjet rresht dhe i ka pranuar të gjitha kushtet tona. Dua të sqaroj që zhvillimi i çfarëdo lloji projekti të ri, bëhet brenda një plani menaxhimi. Parku i Butrintit nuk është vetëm

arkeologjik, por edhe natyror. Në bashkëpunime me UNESCO do të punojmë për ligjin trashëgimie dhe më pas për planin e menaxhimit. Për sa i përket investimeve, jam dakord që duhet të rentabilizojmë të gjitha burimet. Asnjë investim nga taksapaguesit shqiptar, por investime nga burime të treta"-deklaroi ministria para deputetëve.

Ndërkaq, pas debatit të madh që përfshiu opinionin publik gjatë muajit tetor, ministria Kumbaro, ndër-

## Ministria: UNESCO ka kërkuar të vazhdojmë punimet

preu punimet që po bëheshin atje, duke bërë me dije se ndërpriten për një periudhë të papërcaktuar, derisa të shterohen të gjitha pikëpyetjet që ka për këtë projekt të miratuar prej Këshillit Kombëtar të Restaurimit që drejtohet prej saj, projekt që, në fakt, është hartuar nga vetë Instituti i Monumenteve të Kulturës.

Më herët, gjatë ditës së mërkurë, ministria e Kulturës në Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, ku ishte duke u diskutuar Buxheti 2018, tha se ka marrë një shkresë nga UNESCO ku i thuhet të vazhdojmë punimet dhe të mbajnë të informuar UNESCO-n.

**NDËRTIMI**


Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", ministria Kumbaro tha në tetor se "Nuk po ndërtohet asgjë e re. Një vit më parë kemi përgatitur një udhëzim të detajuar për krijimin e këndeve të shërbimit, që i kualifikëndet SAL (Suvenir, Art, Libra) në sitet e trashëgimisë kulturore". Ajo shtoi se po bëhet ripërdorimi i një objekti ekzistues, pa i shtuar asnjë centimetër vullm, pa i shtuar asnjë

centimetër ndërtim dhe pa gërmuar nëntokën, si kusht i domosdoshëm përderisa jemi në zonë arkeologjike.

"Godina në fjalë është aty ku ka qenë, as nuk e lëvizëm, as nuk e afruam. Mbrapa godinës ndodhet muri (I shek7-8), por i cili nuk preket fare dhe nuk ka fare lidhje me projektin. Puna përqendrohet në rehabilitim e kësaj godine. Nuk preket absolutisht asnjë lloj guri tjetër dhe asnjë lloj muri tjetër dhe nuk bëhet asnjë ndërhyrje jashtë këtyre objekteve. E dyta, nuk bëhet asnjë lloj gërmimi, vendoset vetëm një shtresë me një rrjetë hekuri, për të vënë platformën mbi të cilën vendoset druri e xhami. Sa i takon procedurën, kjo nuk bëhet me buxhete publike, as me buxhete e parkut, bëhet me investim të kompanisë që ka fituar procedurën, e cila jo vetëm bën gjithë investimin fizik, jo vetëm do të paguajë edhe qiranë, por i gjithë ky investim i mbetet parkut, edhe pas përfundimit të kontratës me subjektin përkatës, që është një shërbim që ofrohet me outsource, por krejtësisht i kontrolluar, i fiskalizuar dhe i formalizuar".

## RIKTHEHET MISTERIOZJA ELENA FERRANTE, "HISTORI ARRATIE E QËNDRERE"

**E**dashuronte, po, si në filma - dhe e respektonte. ... I kish thënë se ditë e natë mendonte për Lilën, dhe jo me dëshirën normale, por me një dëshirë krejt të panjohur edhe për të. Në të vërtetë nuk e donte. Domethënë, nuk e donte siç i donte ai femrat në përgjithësi, për t'i ndier nën vete, për t'i rrotulluar sipas qejfit, për t'i hapur, thyer, shkelur me këmbë dhe shkalafitur. Nuk e donte për ta shtënë në dorë dhe harruar. E donte për delikatesën e kokës plot ide. E donte për shpirtin krijues. Dhe e donte pa e prishur, për ta pasur gjatë. E donte jo për ta palluar, ajo fjalë e zbatuar mbi Lilën e turbullonte. E donte për ta puthur e ledhatuar. E donte që ajo ta ledhatonte, ta ndihmonte, t'i printe udhë, ta komandonte. E donte për të parë si ndryshonte me kalimin e kohës, si plajej. E donte për të arsyetuar dhe për t'u ndihmuar në arsyetim".



të vëllimi i tretë i sagës napolitane, pas romaneve "Mikesha gjjeniale" dhe "Mbiemri i ri". Elena vazhdon të rrëfejë historinë e jetës së saj e, në mënyrë të tërthortë, edhe atë të Linës. Ato janë tashmë gra: Lila është martuar, ka lindur një fëmijë dhe është ndarë nga bashkëshorti i saj abuzues. Elena është larguar nga lagjia e fëmijërisë, është diplomuar dhe ka bota një roman të suksesshëm, ngjarje që i kanë hapur dyert e salloneve intelektuale e mondane. Të dyja gratë janë përplasur me muret e burgut që do t'i kishte mbajtur në ndrydhura në një jetë varfërie, injorance dhe nënshtrimi. Më në fund, atyre po u ofrohen mundësitë e mëdha, toka e premtuar e emancipimit femëror. E megjithatë, fantazmat e së shkuarës nuk janë larguar, hendeqet nuk janë mbushur dhe ndryshimet i kanë rrënjët ende të njoma.

"Të mirë a të këqij qofshin, të gjithë burrat mendojnë se pas çdo bëme duhet t'i ngrësh në altar si

Shën Gjergji që vret dragoin", shkruan autorja, duke shënuar me tuftë se "Kjo hedhje e shkujdesur fare e meshkujve të trallitur nga kënaqësia! Na plenojnë të rrëmbyer nga orgazma e tyre. Shfaqen brenda nesh dhe sprapsen duke na lënë, të fshehur në mish, fantazmën e tyre si një send të humbur".

"Histori arratie e qëndrese" rrëfen mbi të gjitha për rrënjët dhe të kaluarën, për historinë personale që gëlon thellë brenda nesh dhe na dikton, me hir e me pahir, gjestet e vogla e deri zgjedhjet e mëdha, ato që na përkufizojnë ose na kufizojnë në diçka, në dikë, shumë herë më të vogël, të pisët e të varfër se

ç'jemi të bindur se jemi. E megjithatë, arratia qëndron gjithmonë në imagjinatën kolektive si një nga zgjedhjet, ndoshta më e mira, e një sërë të këqijave të pakurueshme, si varfëria, injoranca dhe dhuna të naktësura thellë në shoqëri. Askush nuk arrin të arratiset vërtet, por të gjithë mudohejmë, qoftë edhe një herë të vetme, të arratisemi nga lagjia, nga qyteti, nga vendi apo thjesht vetja jonë. Saga napolitane është botuar në 40 vende të botës dhe deri më sot, ka shitur rreth tre milionë kopje.

Elena Ferrante është pseudonimi i autores së dhjetë veprave

letrare, ndër të cilat edhe saga napolitane, e konsideruar si kryevepra e saj, nga pikëpamja e kritikës letrare, por edhe falë suksesit të jashtëzakonshme me lexuesit. Emri i vërtetë i autores mbetet ende zyrtarisht i pakonfirmuar. Në 2011 u botua kapitulli i parë i sagës napolitane, "Mikesha gjjeniale" (i botuar në shqip në nëntor 2016), i ndjekur nga libri i dytë, "Mbiemri i ri" (i botuar në shqip në korrik 2017), nga ky vëllim i tretë, i sapobotuar "Histori arratie e qëndrese", dhe nga libri i katërt dhe i fundit, "Storia della bambina perduta".

## AMBASADORI LU U LEXO FËMIJËVE "HAROLDIN ME LAPSIN E PURPURT"

Ambasadori amerikan në Tiranë Donald Lu, u ka lexuar fëmijëve në Bibliotekën Kombëtare së bashku me drejtoreshën Asllani libra nga "biblioteka fëmimore". Miqtë e vegjël të librit zbuluan botën magjike të "Haroldit me lapsin e purpurt" dhe grimca të jetës së shkrimtares Musine Kokalari. "Sa bukur është të lexosh e më të takohesh për një libër! Por edhe më bukur kur librat fëmijëve ua lexojnë prindërit! Do të takohemi sërish ...", shkruan Biblioteka Kombëtare.



Opinion i Ditës

Nga Erjola Jata

(Vijon nga faqja e parë)

... një shërbimi, këto zvarriten apo lihen përgjysmë pa arsye. Sot nuk mund të imagjinohet që një shtet demokratik të funksionojë pa përdorimin e prokurimit në shpenzimin e fondeve publike.

Fatkeqësisht, realiteti ynë është duke u përballur me një nivel të lartë të korrupsionit, veçanërisht në fushën e prokurimit publik. Fusha e prokurimit publik vazhdon të mbetet adresa më e përfolur për keqpërdorime të parasë publike në Shqipëri, për të cilën nevojitet urgjentisht një reformim ligjor sikundër është "VETINGU".

Abuzimi me fondet e buxhetit të shtetit nëpërmjet procedurave tenderuese, nuk përbëjnë realitet të ardhura për ekonominë e vendit, nuk taksohen sipas ligjit dhe përbëjnë stanjacion të ekonomisë. Korrupsioni në fushën e prokurimit, përbën një kërcënim real, i cili po pengon rritjen ekonomike të vendit, sepse ndikon drejtpërdrejtë në uljen e efikasitetit në sektorin privat dhe në atë publik. Disa ditë me parë Kryeministri Rama paralajmëroi më shumë fonde me buxhetin e ri për ndërtimin e rrugëve, por edhe me projektin "1 miliard euro investime".

Po t'i referohemi tabelave zyrtare që ofron buxheti parashikohet të mbyllet 10 rrugë, por shumica e tyre janë investime në rikonstrukcion apo riveshje punimesh. Pjesën më të madhe të fondeve do ta ketë Unaza e madhe e Tiranës. Projektet e tjera do të jepen me

## Vetingu i tenderëve



koncesion. Buxheti do të shpenzojë para të tjera për koncesionet, ku në total ato do të zënë 9,4 miliardë lekë. Por a do të ketë transparencë në këto koncesione, a do të merret parasysh analiza e riskut sipas standardeve që kërkon FMN? Në këto kushte nevojitet reformim rrejtësor i sistemit të prokurimeve në mënyrë që të eliminohen edhe mundësitë e korrupsionit me tenderët publik.

Mënyra sesi zhvillohen sot tenderët dhe kriteret e përcaktuara në to shpallin fitues të njëjtat kompani çka lë të kuptohet për korrupsion ose lë të kuptohet për lënie rryshfeteshe dhe një shfrytëzim jo eficient të fondeve publike.

Korrupsioni duhet të zbulohet dhe denoncohet, të sigurohemi se nuk ka vend ku të fshihet, për të penguar evazionin fiskal dhe për të vënë në dukje vjedhjen ose

keqpërdorimin e taksave të taksapaguesve, por kjo kërkon një vendosmëri të lartë dhe një proces rrejtësor reformimi ligjor në fushën e prokurimeve. Kryeministri Rama me zë të lartë kërkoi që abuzuesit e fondeve publike të vihen para drejtësisë. Por a do të ndodhë kjo? Shumë raporte të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe ministrive denoncojnë raste abuzive me tenderët në rrugë, ku kompanitë kanë

zvarritur projektet edhe pse lëkët u janë disbursuar.

Kemi rastin e kompanisë italiane "Serenissima", ku dy projektet më të rëndësishme të jugut by-paset Fier e Vlorë parashikoheshin të mbylleshin që në 2013, por kompania për shkak të borxheve, nuk paguante nënkontraktorët e vet. Punimet janë lënë përgjysmë. Në Vlorë janë kryer 45% e tyre dhe qeveria u detyrua të rihapë tenderin edhe një herë nga e para në muajin gusht. Ky fakt drejtpërdrejtë ndikon në performancën dhe shpërdorimin e buxhetit të shtetit pasi pasurojnë në mënyrë të paligjshme persona të caktuar, të cilët janë të lidhur qoftë në mënyrë direkte apo indirekte në proceset e prokurimit publik.

Por kjo nuk është sorollatja e vetme.

Qeveria në 2017 ka dhënë me koncesion edhe shërbimin e ambienteve laboratorike për analizat ku fillimisht parashikoi që me buxhetin e vet t'i jepte kompanisë 13 milionë dollarë, por gjatë rrugës pagesa e dyfishuar arriti në 27 milionë dollarë. Bëhet fjalë për një shërbim që kryhet në ambiente spitalore të shtetit dhe ku privati investon vetëm në blerjen e kiteve që kryejnë analizat dhe ato minimumi kushtojnë 3 milionë euro. Në këto kushte situata kërkon patjetër "REVOLUCION" në fushën e prokurimit, ku shteti të kujdeset nëpërmjet mekanizmave ligjor dhe të jetë garantues i konkurrencës së lirë dhe të ndershme me operatorëve ekonomikë. Duhet të shpërblehet me kontratë vetëm ai operator, i cili plotëson kushtet, kriteret dhe rregullat konform ligjit në fuqi për prokurimet publike.

Dje në 'Deutsche Welle'

Christoph Hasselbach

Një kufomë e politikës është ringjallur. "Berluskoni jeton" titullonte e përditshmja "La Verità" artikullin e saj dhe një karikaturë në "Corriere della Sera" e tregon Berlusconi duke dalë nga një varr si Llazari në Testamentin e Ri. 81-vjeçari ka qenë katër herë kryeministër dhe ka lënë pas një sërë skandalesh, afëra seksuale dhe një gjykim për evazion fiskal. E megjithatë, influenca e tij në politikën italiane është sërish e pranishme. Ai vetë nuk kandidon në zgjedhjet rajonale në Sicili. Sidoqoftë, Berlusconi në sfond është përpjekur që kampi i qendrës së djathtë me Nello Musumeci të ketë një kandidat të përbashkët e ai ka bërë reklamë për të. Musumeci fitoi zgjedhjet me 40 për qind. "Sicilia, ashtu sikurse e kam kërkuar unë, ka votuar për rrugën e ndryshimeve", shprehet i entuziazmuar Berlusconi në një mesazh me video në "Facebook".

Vërtetë Sicilia tradicionalisht zgjedh në mënyrë konservatore, por kryeministri i deritanishëm socialdemokrat ishte një përjashim. Ndërsa, aleanca e Musumecit është më shumë se sa konservatore. Ajo bashkon partinë e moderuar të djathtë të Berlusconi Forza Italia me Lega Nordin ksenofobe si dhe me një parti tjetër të ekstremit të djathtë me emrin

## Berluskoni përgatit rikthimin e madh

"Vëllezërit e Italisë". Musumeci konsiderohet si "postfashist".

Partia më e fortë si parti më vete doli lëvizja kritike ndaj Europës "Pesë Yjet" me rreth 35 për qind, ndërsa socialdemokratët janë ndëshkuar ashpër nga zgjedhësit. Kampin e qendrës së majtë e ka dëmtuar jo vetëm bilanci i dobët i politikës rajonale, por edhe përçarjet brenda vetes. Kjo vlen edhe në nivelin kombëtar. Tek e fundit, pjesëmarrja e ulët në votime pasqyron frymën në ishull: më pak se një në dy zgjedhës ka votuar.

Problemet e Sicilisë janë problemet e Italisë

Në thelb problemet e Sicilisë janë edhe problemet e të gjithë Italisë, vetëm se më keq: borxhe të larta, papunësi e lartë (tek të rinjtë është i prekur më shumë se një në dy vetë), rritje e dobët ekonomike, influencë e mafies. Këtyre u shtohet edhe kriza e refugjatëve prej afërsisë me Afrikën. Partitë e djathta në luftën elektorale ngrinin zërin kundër emigrantëve - e me sa duket, me këtë temë kanë tërhequr elektorat. Ndaj edhe zgjedhjet rajonale konsiderohen si test për zgjedhjet parlamentare në maj të vitit të ardhshëm në mbarë Italinë.

Nëse u referohesh rezultateve në Sicili, Italia ndodhet para një zhvendosjeje të qartë, larg socialdemokratëve dhe drejt lëvizjes "Pesë Yjet" ose aleancës së re të qendrës së djathtë si në Sicili. Kandidati kryesor i "Pesë Yjeve", Luigi di Maio është aq i sigurt për kauzën e partisë së tij, sa ai e "konsideron të vdekur politikisht" ish-

kryeministrin socialdemokrat, Matteo Renzi.

Berluskoni, për të penguar "Pesë Yjet"?

Por, një tjetër yll është ngjitur tani në qiellin politik, e ky është sërish Silvio Berlusconi. Ai e rekullon aleancën e djathtë sociale si një alternativë serioze kundrejt "Pesë Yjeve". Ai, personifikimi i

skandalit, u premta sicilianeve pas fitores "kthesë rrejtësore, të ndershme, konstruktive bazuar tek ndershmëria, kompetenca dhe përvoja". Maurizio Gasparri, kryetari i grupit parlamentar të Forza Italia-s në senat tha: "Humbja e socialdemokratëve është e evidente. Aleanca e qendrës së djathtë me programin e saj të arsyeshëm, që është projektuar nën kujdesin e Berlusconi ka gjetur mbështetjen e zgjedhësve".

Por, përse kjo ringjallje e Berlusconi të zhytur në skandale? Historiana Anna Foa në një intervistë me agjencinë e lajmeve "Reuters" konstaton me dëshpërim: "Ky është një vend, në të cilin fiton votat e zgjedhësve, duke shkelur rregullat". Ndërsa, kolegu i saj, Giovanni Orsina mendon: "Berlusconi është si një makinë e përdorur me garanci. E di se çfarë merr".

Tani për tani nuk duket sikur socialdemokratët në pushtet do të mund t'i rifitojnë zgjedhjet vitin e ardhshëm. Nëse lëvizja "Pesë Yjet" nuk fiton, atëherë do të jetë aleanca e qendrës së djathtë nën drejtimin e Berlusconi, ajo që do të vijë në pushtet. Deri tani Berlusconi pas dënimit, duket se nuk do të mund të bëhet më kryeministër. Por, 81-vjeçari shpreson që Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut deri atëherë do ta rrëzojë vendimin. Por, edhe sikur ai të mos bëhet kryeministër, nëse fiton aleanca e tij e Forza Italia-s, Lega Nord-ti dhe "Vëllezërit e Italisë", Berlusconi do të jetë burri i fuqishëm në sfond. Ky do të ishte një Comeback i pashembullt.



Mesazhi i Ditës

# Progresi i reformave, jetik për konvergim ekonomik me BE-në

Nga Ilir Meta

(Vijon nga faqja e parë)

... disa mësimë bazë, të cilat interesi politik i ditës tenton shpesh t'i anashkalojë duke krijuar mangësi të theksuara strukturore, si dhe duke na bërë shumë vulnerabël përpara krizave të tilla që kanë efekt frenues të fortë dhe të shtrirë në kohë.

Pa diskutim që për një organizim relativisht të ri ekonomik, siç është eurozona, përballimi i efekteve të krizës ishte një moment sprovë dhe kërkonte vendimmarrje të shpejtë për të vlerësuar efektivitetin e mekanizmave mbrojtës ekzistues, si dhe krijimin e mekanizmave të rinj për t'iu përshtatur situatave të krijuara.

Efektet e krizës në ekonominë reale dhe segmentin financiar u shoqëruan me nivele të larta të borxhit publik, tolerancë të ulët ndaj riskut në investime, ritëm të ulët në zgjerimin e tregtisë botërore, si dhe riatdhesim të investimeve të huaja direkte jashtë.

Edhe pse disa me vonesë, efektet e krizës u ndjenë edhe në ekonominë tonë duke u shoqëruar me një trend të qartë ngadalësues të ritmit të rritjes. Ky ngadalësim nxori në pah mangësi të shumta strukturore duke ndikuar drejtpërdrejt në rritje të borxhit publik, rritje të papunësisë, rritje të kredive me probleme në sistemin bankar, si dhe vështirësi financiare për bizneset dhe familjet.

Gjej rastin të vlerësoj Bankën e Shqipërisë për rolin proaktiv në zbutjen dhe menaxhimin e efekteve të kësaj krize.

Politika monetare akomoduese e ndjekur prej saj ka kontribuar në rritjen e ekonomisë së vendit dhe në lehtësimin e barrës financiare mbi kredimarrësit privatë, nëpërmjet lehtësimit të kushteve të financimit dhe zgjerimit të kreditës në lekë.

Kjo politikë monetare rezultoi me efekte pozitive në disa drejtime: duke kontribuar në uljen e normave të interesit në të gjitha produktet e tregut financiar, në reduktimin e primeve të rrezikut në tregjet financiare, si dhe në ruajtjen e një situatë të qëndrueshme të likuiditetit.

Të dhënat e fundit ekonomike të disponuara konfirmojnë trendin rritës të ekonomisë shqiptare, i mbështetur kryesisht prej zgjerimit të kërkesës së brendshme të sektorit publik dhe privat, si dhe nga rritja e kërkesës së huaj.

Zhvillimet pozitive ekonomike në vendet e eurozonës dhe jo vetëm kanë ndihmuar në rritjen e eksporteve dhe të aktivitetit turistik.

Megjithatë, edhe pse trendi rritës i ekonomisë shqiptare pritet të vazhdojë gjatë periudhës 2017-2019, sfidat që kemi përpara janë të shumta dhe të natyrave të ndryshme.



Së pari, ambienti rregullator evropian i postkrizës dhe politikat e bankave evropiane për uljen e ekspozimit të tyre ndaj vendeve jashtë BE-së mbeten faktorë shtirëngues dhe frenues ndaj zhvillimit.

Së dyti, kthimi i ekonomisë në ekuilibër duke nënkuptuar një rritje ekonomike afatmesme dhe afatgjatë prej 3.5-4% është sërish i pamjaftueshëm për të garantuar një efekt të prekshëm mbi mirëqenien e shtresave të gjera të shoqërisë, si dhe për të konverguar me shpejt me standardet e vendeve të Bashkimit Evropian.

Së treti, modeli i rritjes së ekonomisë sonë vazhdon të karakterizohet nga mangësi të theksuara, të cilat duhen targetuar sa më parë: Kështu, shkalla e diversifikimit sektorial mbetet e ulët me shërbimet që zënë rreth 45% të Prodhimit të Brendshëm Bruto, njëkohësisht, pesha e kërkesës së brendshme mbetet e lartë dhe diversifikimi në terma të eksporteve mbetet i ulët. Ndërkohë, në tregun e punës kualifikimi dhe arsimimi i fuqisë punëtore mbeten larg kërkesave të kohës.

Dhe së katërti, sektori financiar shqiptar karakterizohet nga diversifikimi i ulët sektorial ku sektori bankar përfaqëson segmentin më aktiv dhe më të zhvilluar të sistemit financiar duke përbërë rreth 90% të aktiveve të tij.

Në këtë kuadër, progresi i reformave strukturore është jetik për të mbështetur konvergimin e shpejtë ekonomik dhe institucional me vendet e Bashkimit Evropian.

Reformat e ndërmarra duhet të ndikojnë në ndryshimin e strukturës së ekonomisë, si edhe në përmirësimin e ambientit ligjor e institucional që përcakton nivelin dhe përbërjen e investimeve në vend.

Nevojiten masa të menjëherëshme për të përmirësuar seriozisht klimën e biznesit, për të reduktuar informalitetin dhe korrupsionin, si dhe për të promovuar konkurrencën ndërsektoriale.

Duhet të ndërmerren politika strukturore që rrisin nivelin e kapitalit njerëzor, përmirësojnë infrastrukturën e zhvillimit dhe promovojnë qeverisjen e shëndetshme të kompanive publike dhe private.

Gjithashtu, krijimi i tregut të

kapitalit mbetet një domosdoshmëri pasi ndikon drejtpërdrejt në shtimin e fondeve për t'u përdorur për investime, në diversifikimin dhe në uljen e kostos së burimeve të financimit për kompanitë, si dhe në rritjen e mirëqenies së përgjithshme.

Në çdo rast, parakusht për zhvillimin e tregut të kapitalit mbeten reformat institucionale, forcimi i kornizës ligjore e rregulative dhe stabiliteti makroekonomik.

Duke e mbyllur fjalën time këtu, dua të shpreh një falënderim të veçantë për Bankën e Shqipërisë, që është një institucion mjaft i besueshëm i shtetit tonë, për Guvernatorin Sejko për punën e mirë të bërë në kuadër të garantimit të stabilitetit makroekonomik të vendit, si dhe për iniciativën në realizimin e kësaj konference në bashkëpunim me Qendrën e Studimeve për Evropën Juglindore në Universitetin e Oksfordit.

Punë të mbarë konferencës suaj! Ju faleminderit!

**\* Mesazhi i presidentit në konferencën vjetore të Bankës së Shqipërisë**

## HOROSKOPI

### DASHI

Të dish të zgjedhësh për më të mirën nuk është e lehtë, kur bëhet fjalë të mendoni si për mirëqenien tuaj, ashtu edhe për atë të të tjerëve. Njerëzit i besojnë instinktit tuaj dhe kjo ju pëlqen. Por shrohet pyetja, po ju a i zini besë?

### DEMI

Kalimi i Hënës në qiellin tuaj do t'ju favorizojë lëvizjet, qofshin këto si për kënaqësi ashtu edhe për punë. Negociatat dhe puna do të ecin vaj. Priteni pozitivisht risinë. Edhe pse gjërat nuk ju duken shumë interesante, shumë shpejt ato do të jenë!

### BINJAKET

Jeni shumë i aftë për të çuar përpara negociatat raskapitëse. Por në fund edhe ju mund të ndiheni të shtypur nën ngarkesën e tepërt të përgjegjësisë. Duhet të mësoni të ndani dhe të delegoni punët, ju nuk mund të mbani gjithmonë gjithçka mbi supë.

### GAFORJA

Me Hënën që ndodhet në pozicion të mirë, mendimet tuaja do të jenë më pak të turbullta dhe mund të ndriçoni të gjitha zonat e errëta që ju trembin. Në fund të fundit, kjo është edhe për të mirën tuaj. Nëse partneri ju kërkon pak kohë, jini dispozicion menjëherë.

### LUANI

Pasiguri të vogla për të shprehur emocionet e juaja të brendshme mund ta bëjnë të vështirë që partneri i jetës t'ju kuptojë. Dukeni i përhumur, edhe pse në të vërtetë jeni duke pleqëruar thellësisht mbi një çështje që ju shqetëson.

### VIRGJERESHA

Nëse është e vërtetë se mjafton të duash për ta bërë diçka, është gjithashtu, e drejtë të thuash se të vazhdoni në drejtimin e gabuar, ju bën të humbni shumë nga koha juaj e vyer. Mund të keni nevojë për një ndihmë. Por nuk duhet ta pranoni, nëse do të kishit një përgjigje të tipit "a të thashë!"

### PESHORJA

Para se të futni dorën në kuletë, bëni disa llogari, për të kuptuar se cili shpenzim i tepërt, që nuk ishte i llogaritur mund ta merrni në konsideratë. Nëse mendoni se mund t'ia dini pa pasur një gjë të caktuar për të pasur diçka tjetër, vetëm ju e keni në dorë për të zgjedhur.

### AKREPI

Shumë kërkesa që nuk presin rrezikojnë t'ju vënë për poshtë. Keni dëshirë t'ua përmblidhni dëshirat të tjerëve, por nuk mund të jeni i pranishëm me të gjithë! Gjenerikullitri duhet, duke u udhëzuar nga instinkti dhe nga bonsensi i thjeshtë.

### SHIGJETARI

Do të prisni me frikë ardhjen e një mesazhi të rëndësishëm, që po ju mban nën tension. Hiqeni këtë mendim, nëse nuk doni që të zmadhoni ankthin. Ndoshta, adresa ishte gabim ose dërguesi e ka harruar faren. Por ju nuk i duroni dot pakujdestitë.

### BRICJAPI

Më shumë se për punën dhe afatet që mbarojnë, po mendoni sesi të argëtoheni me ndonjë rrëng të bukur që t'iu kurdisin mikut tuaj më të mirë! Në fillim puna, pastaj kënaqësia, ndryshe do të hani një të ulëtur jo shumë të këndshme.

### UJORI

Më të paqta e më pak agresiv, edhe pse duhet të qortoni dikë që nuk është shumë i vëmendshëm. Vëreni veten gjithmonë në pozicionin e tjetrit, përpara se ta kritikoni. Në çastin më të posaçëm do të dini gjithmonë t'i rimerri në dorë frerët e situatës.

### PESHQIT

Të ngadalësuar nga pozicionimi hënor, ju mungon shpejtësia për të tejkaluar kundërshtarin tuaj si edhe për të fituar kështu një avantazh të konsiderueshëm ndaj tij! Do të jetë një përballje e fuqishme, por ajo që është e sigurt është se nuk do ta shisni kursesi lirë lëkurën tuaj.

Shqipëria përballet sot me Irlandën, ndërsa trajneri kuqezi kërkon maksimumin nga lojtarët



Jeton Selimi

# Bushi: Dua lojë të bukur, pak rëndësi ka fitorja

## Panuçi ka kërkuar 5 lojtarë nga kuqezinjtë U-21

Në konferencën për shtyp para ndeshjes së sotme me Irlandën U-21, trajneri i Shpresave, Alban Bushi, foli për sfidën që e pret sot, si dhe për objektivat dhe grupin që ai ka në dispozicion. Siç u shpreh Bushi, ka qenë vetë trajneri Panuçi i Kombëtares A, që i ka gati 4-5 lojtarë të Shpresave për t'i marrë tek ekipi i tij.

**Ende nuk është shënuar goli i parë në Shqipëri. Keni deklaruar që ju ngroh loja e skuadrës. Çfarë ka të re loja ndaj Irlandës?**

Nuk dua të them që fati nuk ka qenë me ne, pasi ai që punon, ka edhe fatin. Unë jam i kënaqur nga loja sulmuese. Mendoj se do shënojmë nesër. Në ndeshjen e parë me Irlandën kemi pasur raste për të shënuar, por nuk e bëjmë. Shpresoj ta bëjmë nesër (sot).

**Ndonjë strategji e veçantë për Irlandën?**

Në fillim mendonim se të gjitha ekipet do na sulmonin, por tashmë po na rrinë në mbrojtje. Mendoj se nesër duhet të bëjmë durim. Irlanda del shumë shpejt në kundërsulm. Ka lojtarë shumë të shpejtë. Ne kualifikimin e ëndërrujmë. Ne i bëjmë hyzmetin çdo ndeshjeje, pasi jemi ekip i vogël. Nesër ndaj Irlandës do japim maksimumin. Është diçka pozitive që çojmë lojtarë edhe në ekipin A. Përveç rezultatit, duhet të shqetësohemi edhe për këtë.

**Pas Ramadanit, keni ndonjë lojtar tjetër që Panuçi ju ka kërkuar?**

Dua ta falënderoj Panuçin, pasi më uroi sukses për nesër dhe na ndjek gjithmonë. Kam biseduar me të dhe ai gjithmonë insiston tek lojtarët e rinj. 4-5



lojtarë ai i ka në mendje dhe kërkon t'i marrë.

**Barazim dhe humbje në ndeshjet e fundit. Ju vjen keq për këto rezultate, kur keni zhvilluar lojë të mirë?**

Normale që më vjen keq. Nuk do më vinte keq nëse do

luanim keq, por këto ndeshjet e fundit kemi bërë lojë të mirë. Në Irlandë na shënuan në minutën e 95-të me penallti, por tashmë e kemi harruar. Lojtarët janë të rinj dhe nuk duhet të kenë presion. Edhe publiku është i

rëndësishëm për ne. Çunat e kanë justifikuar veten me lojën që kanë zhvilluar.

**Mund të na zbuloni diçka nga formacioni?**

Për fat të keq me Islandën dhe Irlandën nuk kemi pasur Durmishajn, lojtarin

më të mirë sulmues. Do bëjmë një lojë sulmuese, duke pasur edhe ekuilibrat mbrapa, pasi është shumë e rëndësishme. Nesër mund të kemi shumë sulmues në lojë, por kërkoj që të jenë të kujdesshëm edhe në mbrojtje.

**Jeni diplomat dhe i rezervuar në lidhje me kualifikimin. Është objektivi i juaj ky?**

Duke pasur Spanjën në grup, është shumë e vështirë të kualifikohemi, por nuk është e pamundur. Nuk është çudi që të mundim edhe Spanjën. Por ne kërkojmë të mundim Irlandën nesër. Nëse bëjmë këtë lojë që kemi bërë deri tani, jam i kënaqur. Nuk më intereson nëse nuk fitojmë. Edhe tifozët janë të rëndësishëm, pasi na japin mbështetje. Kërkoj nga tifozët që të mbështesin edhe të rinjtë e Kombëtares. Nuk mund të fitojmë në një stadium bosh, pa tifozë.

**Ish-trajneri Hafizi ka bërë një përsëritje për ju dhe për Bogdanin. Si e lexoni deklaratën e Hafizit, ku deklaroi se duhet të ndërhyri më shpejt?**

Patjetër që rezultati është i rëndësishëm, por objektivat i vendos institucioni. Objektivi ynë është të kemi sa më shumë lojtarë në ekipin A. Kemi bërë një punë të mirë, por edhe rezultatit e kemi pasur. Nuk mund të krahasohemi me kombëtare të mëdha moshash si Spanja.

### MESFUSHORI ËSHTË DËMTUAR



## Migjen Basha largohet nga grumbullimi

Grumbulluar në ekipin Kombëtar për sfidën ndaj Turqisë që do të zhvillohet në 13 nëntor, me shpresën që do të riaftësohej në kohë, por mesfushori Migjen Basha nuk ia ka dalë. Pas disa seancave stërvitore të zhvilluara veçmas skuadrës, 30-vjeçari është larguar nga rezidenca e ekipit përfaqësues në Antalia. Mesfushori do të vazhdojë të ndjekë fazën e rikuperimit pranë klubit të tij. Për efekt të kohës së shkurtër, trajneri Panuçi nuk do të thërrasë zëvendësues të ri.

### BENEVENTO



Rekord humbjesh, presidenti i Memushajt: Fajin e kanë shtrigat

Benevento, ekipi i fundit në klasifikimin e Serisë A italiane po kalon një formë skandalozë në kategorinë më lartë të futbollit në gadishullin apenin. Nga 12 ndeshje që ka luajtur ekipi ku aktivizohen edhe Memushaj e Gjimshtiti, i ka humbur të 12-ta. Rekordi tjetër negativ janë edhe 31 golat e pësuar dhe vetëm 5 të shënuar, teksa edhe faza e parë e kampionatit po i drejtohet fundit. Por, presidenti Oreste Vigorito e gjen fajin tek diçka e pazakontë, për lojën e dobët të skuadrës së tij. "Marrim lëvdën nga çdo anë, por gjithmonë pa pikë të fituara. Fajin e ka ndikimi i ligës, që gjithmonë është lidhur me këtë qytet. pra shtrigat. Po, e vërtetë. Jam paragjykes", ka thënë Vigorito për "Gazzetta dello Sport".

### MESFUSHORI U-21



Bare: Jemi në formë, penalltitë i cakton trajneri

Mesfushori i Kombëtares U-21, i cili aktivizohet edhe tek Atletico e Madridit në Spanjë, doli në konferencën për shtyp para ndeshjes me Irlandën, bashkë me trajnerin Alban Bushi. Ai foli për penalltinë e humbur ndeshjen e fundit dhe për formën që po kalon ekipi. "Ndihej në formë, shpresoj të tregoj të njëjtën gjë edhe nesër në fushë. Kemi punuar me goditjet në portë dhe do kërkojmë të shënojmë. Penalltia që shkaktova në Irlandë është përfolur shumë, por unë i dua të mirën ekipit në çdo rast. Dua të sqaroj se nuk ishte e qëllimshme. E vendos trajneri se cili i godet penalltitë, por unë do jem gjithmonë gati për të ekzekutuar. Gjithsesi, ky vendim i përket Bushit për ta marrë."

## Juventusi hedh sytë nga Thomas Strakosha

ZËVENDËSUESI I BUFONIT

Bepe Marota vendosi ta fuste në listën e dëshirave të tij që në momentin kur ai ndali Dibalán nga pika e bardhë dhe që prej asaj dite, Thomas Strakosha ka fituar gjithmonë e më shumë terren në strategjinë e Juventusit për të ardhmen. Portieri i Kombëtares Shqiptare, edhe pse pak javë më parë rinovoi deri në vitin 2022 me Lacion, do të jetë një nga emrat më të përfolur në Itali gjatë merkatos verore. Numri 1 i Lacios është rënditur në listën me 50 emrat e


katija e ardhshme vështirë se mund ta largojë 22-vjeçarin nga kryeqyteti dhe këtë e tregon edhe përqindja e vendosur në krah të emrit të tij pasi sipas gazetës, Strakosha ka vetëm 10% mundësi transferimi duke ditur se Lacio e ka blindur me një kontratë afatgjatë dhe e konsideron pjesë të projektit dhe mund të vendosë ta shesë vetëm për një shifër stratosferike. Në këtë rast, Juventus mund vetëm të presë për të studiuar situatën, por e ardhmja mund të dhurojë surpriza për një nga portierët më të talentuar kuqezinjtë.

## JOSHJA

### Ramos thërret Neymarin: Të presim krahëhapur te Reali

Nejmar te Real Madrid? Ndoshta. Serxho Ramos i ftuar në emisionin e njohur në Spanjë "El Larguero" në "Cadena Ser", e pret me krahëhapur një transferim të brazilianit në Madrid. Verën e kaluar Nejmar u largua nga Barcelona te Paris Saint Germain për shifër rekord të 222 milionë eurove, por ditët e fundit është zbuluar në media se futbollisti është përdur për zgjedhjen e klubit francez. Florentino Perez, presidenti i Real Madrid, është gati për të hyrë në negociatë, pasi ai shihet si pasuesi ideal i Cristiano Ronaldo. "Do të më pëlqente që të kisha në skuadër më të mirët dhe Nejmar është një prej tyre. Është një ndër më të mirët në botë dhe është më e thjeshtë që të vijë në Madrid duke e krahasuar me transferimin në Francë. Unë do ta marrja menjëherë, është një lojtar i ndryshëm, që mund të bëjë diferencën dhe i ka portat e hapura nëse do të vijë", ka thënë Ramos për mediat iberike.

**Fjalëkryqi (1)**



**HORIZONTAL**

2. Gjëja e latinëve.
5. Ai i Kuq u hap për hebrejtë.
9. Eshhtë fjala e për e foshnjës.
11. Ministri Ekonomisë e Pune
13. Marubi i fotografisë.
14. Bel i Mapupassant.
15. Bëhet duke tregtuar objekte të shenja.
18. Derek aktore.
19. Gjysmë totale.
20. Eshhtë arti i të folurit
22. Një patriark biblik.
24. Mund të jenë zemërkau të tilla.
26. Janë dëshmorë të kishës.
28. Eshhtë lloj papagalli.
29. Eshhtë lloj papagalli.
30. Qerre pa qe.
32. Ekstrema në numërim.
33. Eshhtë bodrumi.
34. Steiger aktor.

35. Inicialet e Delon.
37. Eshhtë edhe ai Me Gropa.
38. Një mund të jetë autonom.
40. Në krye të evidencës.
42. Edgar Allan Poe.
44. Ekstremit në litar.
46. Giorgio i modës.
50. Janë malet me Akonkagua.
52. Janë ujërat e bregdetit tonë.

**VERTIKAL**

1. Novarro që qe aktor.
3. Kusturica regjisor.
4. Eshhtë e jashtëzakonshme.
6. Inicialet e Kazan.
7. Ishte qyteti i 100 portave.
8. Pinci i Dy herë mat.
9. Janë të mirat që prodhohen.
10. Eshhtë ai që gënjën për tu bërë i njohur.
11. Një markë celulari.
12. Ushtrohej nga filibusterët.
16. Një përsiatje.
17. Agjenci Informative Tiranë.
21. Një bregtës pylli.
23. Një Gjon që qe aktor i yni.
25. Titulli i Byron.
27. Në radhë të parë.
31. Emri i Amundsen.
36. Moore aktore.
39. Pishtarë pa pishë.
41. Gjysmë vatani.
43. Rruga e Molnar.
45. Një fazë gjumi.
47. Inicialet e Redford.
48. Në krye të notarëve.
49. Inicialet e Reitman.
51. Unë dhe ti.


**Fjalëkryqi (2)**

**HORIZONTAL**


1. Nuk kalohet nga mbetësi.
5. U printe gladiatorëve
12. Bëhet duke shkuar lart e më lart
14. Tatum që qe pianist.
15. Një që lufton për para
16. Mund të bëhet me safari
17. Breshkat luftarake të kartonave
19. Ngjitet kur nuk nget
20. Në mes të rrugës
21. Sporti me rikisha
25. U shkrua nga Hesiodi
26. Një sferë për model
27. Mbyllin një sirtar
28. Makina Tipò
30. Inicialet e Bean, aktor
31. Nino, kompozitor i famshëm italian
33. Ramiro pa zë.
34. Neill i Jurassic park.
35. E bukura e belle epoqe.

**VERTIKAL**


2. Ishin grekët në trojë
3. Ishin palate të beut
4. Goodëin, ndihmësi i Nero Wolfe
5. Pak singëritet
6. Personazhet e Charles Schulz.
7. Kompozoi Mefistofele
8. Në radhë të parë.
9. Qytet zviceran
10. Në krye të kryesisë
11. Ughi violinist
13. Carlos që qe pilot i Formula 1
15. Ekstrema në muzg
18. Inicialet e Steinbeck
22. Gruda, "Njeriu me top"
23. Eshhtë X ajo e sulmit
24. Paradhoma e parajasës
28. Eshhtë edhe ai i luftës
29. Janë edhe ato të cirkut
31. Mbarojnë fare
32. Inicialet e Reed, aktor
34. Të parët në sondazh
36. Eshhtë taksa
38. Një mund të jetë emërore
39. Një pjesë e marrëzisë
41. Gjysmë mimoze
42. Hundë kur s'jam unë
43. Skuadër greke
44. L'emper, këngëtare gjermane
46. Fundi i një akti



**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**SUDOKU**

			5				1		
8	3			2	6				4
9		4		3			7		6
		6	2				1	4	9
		8					3		
5	9	2			4	6			
1		9		8		2			7
7			1	9			6	5	
	2				3				

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

2	3	7	9	5	8	4	6	1	
9	4	5	3	1	6	8	7	2	
1	8	6	4	7	2	3	9	5	
5	9	4	1	2	7	6	3	8	
7	6	3	5	8	4	1	2	9	
8	1	2	6	9	3	5	4	7	
3	2	8	7	4	5	9	1	6	
6	5	9	2	3	1	7	8	4	
4	7	1	8	6	9	2	5	3	

*Argëtim filozofik*

- Sa barrë e rëndë është një emër që është bërë shumë i famshëm. (Volter)
- Fama vjen zakonisht tek ata që janë duke menduar për diçka tjetër. (Oliver Uendell Holms, i riu)
- Të besosh në atë që mendon, të besosh se ajo që është e vërtetë për ju, thellë në zemrën tuaj, është e vërtetë për të gjithë njerëzit, ky është gjeniu. (Ralf Valdo Emerson)

**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**  
Përgjigja e numrit të djeshëm

17	1	8	4	2	4	13	1	13	1
18	3	1	4		18	3		17	13
8	1	10		10	10	1	3	1	6
3		1	10	2	3	6	14	1	12
	13	3	5	4	2	8	4	1	12
15	9	6	15	1	12	4	6		6
17	2	4	5	12	2	14		17	5
	8	1	7	6	3	1	10	1	
1	5	12		4	6	4	18	7	1
1	3	2	8		1	5		2	12
20	19		1	3		20	5	4	6
6	1		10	2	3	2	12	15	18

- Të gjithë ankohe mi për kujtesë të pamjaltueshme, por asnjë deri më sot nuk është ankuar për mungesë arsyeimit të shëndoshë. (Laforushko)
- Njeriu me të vërtetë i fortë, i pohan dobësitë e veta. (Balzak)
- Fëmijet gjejnë gjithçkanë në asgjë, kurse të rriturit argëtohen në gjithçkal (Giacomo Leopardi)
- Miku më i madh i së vërtetës është koha, më i madhi armik i saj është paragjykimi, ndërsa shoqërujesja e përhershme është përlësia. (Koltoni)

*Thënie të mençura*

**PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR**

**FJALËKRYQI (1)**

HORIZONTAL

2. Gjëja e latinëve: GJËJA

5. Ai i Kuq u hap për hebrejtë: MOISE

9. Eshhtë fjala e për e foshnjës: MAM

11. Ministri Ekonomisë e Pune: BASHKIM

13. Marubi i fotografisë: KADRE

14. Bel i Mapupassant: BELI

15. Bëhet duke tregtuar objekte të shenja: TREGTAR

18. Derek aktore: DEREK

19. Gjysmë totale: GJYSMË

20. Eshhtë arti i të folurit: FOLITJE

22. Një patriark biblik: ABRAHAM

24. Mund të jenë zemërkau të tilla: ZEMËRKAU

26. Janë dëshmorë të kishës: DËSHMORË

28. Eshhtë lloj papagalli: PAPAGALLI

29. Eshhtë lloj papagalli: PAPAGALLI

30. Qerre pa qe: QERRA

32. Ekstrema në numërim: EKSTREMA

33. Eshhtë bodrumi: BODRUMI

34. Steiger aktor: STEIGER

**FJALËKRYQI (2)**

HORIZONTAL

1. Nuk kalohet nga mbetësi: NUK

5. U printe gladiatorëve: UPRINT

12. Bëhet duke shkuar lart e më lart: SHKUAJ

14. Tatum që qe pianist: TATUM

15. Një që lufton për para: LUFTON

16. Mund të bëhet me safari: SAFARI

17. Breshkat luftarake të kartonave: BRESHKAT

19. Ngjitet kur nuk nget: NGJITET

20. Në mes të rrugës: RRUGË

21. Sporti me rikisha: RIKISHA

25. U shkrua nga Hesiodi: SHKRUAR

26. Një sferë për model: SFERË

27. Mbyllin një sirtar: MBYLLIN

28. Makina Tipò: MAKINA

30. Inicialet e Bean, aktor: BEAN

31. Nino, kompozitor i famshëm italian: NINO

33. Ramiro pa zë: RAMIRO

34. Neill i Jurassic park: NEILL

35. E bukura e belle epoqe: BUKURA

VERTIKAL

2. Ishin grekët në trojë: GREKËT

3. Ishin palate të beut: PALATE

4. Goodëin, ndihmësi i Nero Wolfe: GOODËIN

5. Pak singëritet: SINGËRITET

6. Personazhet e Charles Schulz: PERSONAZHET

7. Kompozoi Mefistofele: MEFIstofele

8. Në radhë të parë: RADHË

9. Qytet zviceran: QYTET

10. Në krye të kryesisë: KRYE

11. Ughi violinist: UGHI

13. Carlos që qe pilot i Formula 1: CARLOS

15. Ekstrema në muzg: EKSTREMA

18. Inicialet e Steinbeck: STEINBECK

22. Gruda, "Njeriu me top": GRUDA

23. Eshhtë X ajo e sulmit: X

24. Paradhoma e parajasës: PARADHOMA

28. Eshhtë edhe ai i luftës: ESHËTË

29. Janë edhe ato të cirkut: JANË

31. Mbarojnë fare: MBAROJNË

32. Inicialet e Reed, aktor: REED

34. Të parët në sondazh: TË PARËT

36. Eshhtë taksa: TAKSA

38. Një mund të jetë emërore: NJË

39. Një pjesë e marrëzisë: NJË

41. Gjysmë mimoze: GJYSMË

42. Hundë kur s'jam unë: HUNDË

43. Skuadër greke: SKUADËR

44. L'emper, këngëtare gjermane: L'EMPER

46. Fundi i një akti: FUNDI

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

# GAZETA SHQIPTARE

# GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

# GSH

www.gsh.al

## GAZETA SHQIPTARE



## Tashmë edhe lundroni!

